

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISSIONI NË KOSOVË**

**E Drejta për Gjykim Korrekt në Rastet e Ndërlidhura
me Zgjedhjet**

Tetor, 2012

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTË E SHKURTESAVE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.1 Konteksti dhe historiku	6
1.2 Raportimi i mëhershëm i OSBE-së për shkeljet e ndërlidhura me zgjedhjet	7
1.3 Qëllimi, fushëveprimi dhe metodologjia e raportit	7
2.1. Korniza normative ndërkombëtare	8
2.2. Korniza normative në Kosovë	10
3. BAZA E DËSHMISË PËR PROCEDURAT E ZHVILLUARA NË RASTET E MASHTRIMIT GJATË ZGJEDHJEVE TË VITIT 2010	12
3.1. Mekanizmi i PZAP-së për ankesa	12
3.2. Procesi i rinumërimit i urdhëruar nga KQZ-ja	12
4. MANGËSITË NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË MASHTRIMEVE NË ZGJEDHJE NË BAZË TË PROCESIT TË RINUMËRIMIT TË URDHËRUAR NGA KQZ-JA NGA PROKURORIA DHE GJYKATAT	14
4.1. Ndjekja	14
4.1.1. <i>Mangësitë e aktakuzave të drejtpërdrejta: dëshmitë e pamjaftueshme, arsyetimi i dobët dhe dështimi për individualizimin e veprimeve dhe përgjegjësisë penale të bashkëpandehurve.</i>	14
4.2. Gjykatat	19
4.2.1. <i>Konfirmimi i aktakuzave: aktakuzat e konfirmuara në mungesë të dyshimit të bazuar ndaj bashkëpandehurve individual</i>	19
4.2.2. <i>Gjykimi kryesor: dështimi për të ekzaminuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë rastet kundrejt të bashkë-të pandehurve individual</i>	20
5. PËRFUNDIMET	26
6. REKOMANDIME	27
SHTOJCA	29

LISTË E SHKURTESAVE

KPK	Kodi Penal i Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
QNR	Qendra për Numërim dhe Rezultate
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
ENEMO	Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
DUDNj	Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të procedurave për mashtrim në votime lidhur me zgjedhjet e vitit 2010 krahasuar me reagimin e sistemit të drejtësisë së Kosovës në keqpërdorimet në zgjedhjet e 2007 dhe 2009. Megjithatë, mangësitë në trajtimin e këtyre rasteve mbesin brengë serioze. Duke u bazuar në gjetjet e procesit të rinumërimit, autoritetet e prokurorisë në Kosovë kanë paraqitur një numër të madh të aktakuzave të drejtpërdrejta për mashtrim në votime të diktura gjatë zgjedhjeve të 2010. Gjykatat i kanë konfirmuar një numër të konsiderueshëm të këtyre aktakuzave dhe dëgjimet e para gjyqësore janë përfunduar. Megjithatë, procedurat në zhvillim shfaqin mangësi të shumta që me sa duket i vënë në rrezik të drejtat e të pandehurve për gjykim të drejtë dhe shkelin kornizën legjislative të zbatueshme në Kosovë.

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë(OSBE) ka vërejtur që, pa asnjë hetim paraprak, prokurorët kanë akuzuar në mënyrë kolektive të gjithë personat që ishin të caktuar si anëtarë të komisioneve të vendvotimeve në të cilat rinumërimi ka gjetur manipulime me fletëvotime që e tejkalojnë prapësin e caktuar. Si rezultat i kësaj, aktakuzat pasuese shfaqën prova të pakta, arsyetim të dobët dhe nuk kanë arritur t'i individualizojnë veprimet dhe përgjegjësitë penale të të bashkëpandehurve të ndryshëm. Në fazën e konfirmimit, gjykatat nuk e kanë shqyrtuar me kujdes të duhur cilësinë e këtyre aktakuzave dhe i kanë konfirmuar shumicën e lëndëve, në mos të gjitha, për t'i kaluar më pas në dëgjim kryesor. Seancat e para të dëgjimit kryesor përfshinin raste ku gjyqtarët nuk e zbatuan parakushtin e kujdesit të duhur në gjykimin e këtyre lëndëve. Mos-marrja parasysh e provave të mjaftueshme dhe relevante, e përforcuar edhe më shumë me mungesë të arsyetimit të duhur në aktvendimet e nxjerra, nxiti dyshime nëse gjykatat i kanë shqyrtuar hollësisht dhe drejt të gjitha faktet relevante për lëndët, kryesisht lëndë që kanë të bëjnë me veprimet individuale dhe përgjegjësinë e të bashkëpandehurve të ndryshëm. Mangësitë e vërejtura duken të jenë serioze në atë masë sa që nuk mund të thuhet se të pandehurit në procedura kanë pasur gjykim të drejtë.

Deri nga gjysma e vitit 2012, 133 nga rastet e kësaj natyre ishin duke u proceduar nga prokuroria, nga të cilët afërsisht 120 ishin në pritje në fazën e konfirmimit dhe të dëgjimit kryesor. Në mënyrë që lëndët e ardhshme të jenë në pajtueshmëri me ligjin e zbatueshëm dhe të sigurohet që të pandehurit i gëzojnë të drejtat e tyre themelore për gjykim të drejtë në mënyrë efektive, ky raport jep disa rekomandime. Prokurorët duhet të kryejnë hetime të hollësishme dhe adekuate dhe duhet të ngrenë aktpadi vetëm atëherë kur të jenë mbledhur prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar kundër të pandehurve individualë. Aktakuzat duhet të mbështeten me arsyetim të duhur që tregon qartë veprimet dhe përgjegjësinë penale të secilit të pandehur dhe të bashkëpandehur. Gjyqtarët do të duhej t'i konfirmonin këto aktakuza vetëm atëherë kur të plotësoheshin kriteret e përcaktuara me ligj dhe duhet t'i mbështesin vendimet e tyre me arsyetim të duhur dhe të mjaftueshëm. Gjatë seancës kryesore, gjyqtarët do të duhej t'i shqyrtonin hollësisht dhe në mënyrë të drejtë të gjitha faktet relevante të rastit. Kjo përfshin administrimin e provave nga gjyqtarët, gjë që është e nevojshme për të vlerësuar dhe përcaktuar veprimet dhe përgjegjësinë e të bashkëpandehurve individualë në mashtrimet në votime. Përfundimisht, gjyqtarët do të duhej të nxirrnin aktvendime të mbështetura me arsyetime të duhura.

1. HYRJE

OSBE-ja ka raportuar më parë për raste të mashtrimit në votime në sistemin e drejtësisë së Kosovës.¹ Raportet e mëparshme ngrinin brenga lidhur me dështimin e prokurorisë për t'i hetuar dhe ndjekur me kohë dhe vendosmërisht aktivitetet mashtruese të kryera lidhur me zgjedhjet në vitin 2007 dhe 2009. Ky raport, nga ana tjetër, pranon që janë iniciuar një numër i shtuar i procedurave penale si reagim ndaj pohimeve për mashtrim gjatë zgjedhjeve të 2010. Ndonëse këto procedura pa dyshim paraqesin një hap pozitiv përpara, qëllimi i këtij raporti është të shqyrtojë në mënyrë të hollësishme jo vetëm sasinë por edhe cilësinë e procedurave që vazhdojnë.

Raporti fokusohet në rastet që kanë dalë gjatë procesit të rinumërimit të urdhëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).² Bazuar në parregullsitë e mëdha të hasura përmes formularëve të përputhjes së rezultateve dhe auditimit fillestar³, KQZ-ja urdhëroi rinumërim në rreth 40 për qind të të gjitha vendvotimeve 40 nëpër Kosovë⁴. Procesi i rinumërimit e konfirmoi që fletëvotimet ishin manipuluar në këto vendvotime. Të gjeturat i janë përcjellë prokurorive përkatëse komunale, të cilat bazuar në ligjin e procedurës penale janë kompetente për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të ndërlidhura me zgjedhjet. Prokuroritë komunale i kanë shfrytëzuar këto gjetje si bazë për të iniciuar procedura penale kundër të gjithë anëtarëve të caktuar në këto vendvotime.

Rastet e ngritura mbi bazë të ri-numërimit të votave përfaqësojnë pjesën më të madhe të të gjitha akuzave për mashtrim të ngritura në lidhje me zgjedhjet e 2010. Monitorimi i sistemit ligjor nga OSBE-së ka treguar që akterët e drejtësisë, prokurorët dhe gjykatat në Kosovë shpeshherë i kanë trajtuar këto raste në mënyrë sipërfaqësore, duke dështuar në

¹ Shih Raportin mujor të Sektorit për Monitorim të Sistemit Ligjor (SMSL) të OSBE-së, të muajit maj 2009. <http://www.osce.org/kosovo/38404> (qasur më 25 shtator 2012), dhe Raportin mujor të tetorit/nëntorit 2008, <http://www.osce.org/kosovo/38443> (qasur më 25 shtator 2012).

² KQZ është organ i pavarur i ekspertëve që janë përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve; shih nenin 3 dhe Kapitullin X të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në republikën e Kosovës, 5 qershor 2008, me ndryshimet pasuese në Ligjin Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, 29 tetor 2010.

³ Qendra për Numërim dhe Rezultate (QNR), organ i KQZ-së, kishte detyrë pranimin dhe kontrollimin e materialeve, përputhjen e formularëve të rezultateve, verifikimin dhe skanimin e listave të votuesve, mbajtjen e të dhënave dhe rishikimin, auditimin, numërimin e votave me kusht dhe atyre përmes postës elektronike, rinumërimin e fletëvotimeve dhe hetimin. Raportet e QNR-së për KQZ-në pas zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010, tregojnë që 760 nga 2,280 vendvotimet (*Lista kryesore e KQZ-së për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2010 në Kosovë, të dhëna teknike zgjedhore*) nëpër Kosovë nuk e kishin kaluar auditimin, dhe fletëvotimet duhej të rinumëroheshin dhe hetoheshin në QNR. Raporti i QNR-së për rivotimet e 9 janarit 2011 gjeti që 92 nga 185 vendvotime nuk e kalonin auditimin. Në përgjithësi, çështjet që janë vënë re më së shumti në QNR ishin gabimet apo të dhënat e pasakta (mashtruese) në formularët e rezultateve të kandidatëve (mbi 90 për qind). Shih Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO), *Misioni për Vëzhgim të Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010, Raporti Përfundimtar*, prill 2011, në f.19–20; http://www.enemo.eu/press/ENEMO_final%20report_KOSOVO_EOM_2011.pdf (qasur më 25 shtator 2012). Sipas Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), në 80 për qind të këtyre rasteve (712 vendvotime) numri i votave për kandidatët kishte mospërputhje me votat për partitë politike. Në pjesën e mbetur prej 20 për qind të rasteve (178 vendvotime), kishte gabime të cilat mund të ishin të natyrës matematikore; shih Raportin e KIPRED, *Krimet e zgjedhjeve*, tetor 2011, http://www.kipred.org/advCms/documents/15928_election_crimes.pdf (qasur më 25 shtator 2012).

⁴ Raporti final i Misionit të Ekspertëve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet në Kosovë, 25 janar 2011, fq. 7 dhe 50. E qasur me 25 shtator 2012 në: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/25012012_final_report_eu_eem_kosovo_2010.pdf

përmeshjen e standardit të domosdoshëm të kujdesit të duhur. Raporti aktual konsideron se procedurat e tilla i shkelin standardet ligjore ndërkombëtare dhe të Kosovës dhe i komprometojnë të drejtat themelore të të pandehurve për gjykim të drejtë.

1.1 Konteksti dhe historiku

Më 12 dhjetor 2010, në Kosovë u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare.⁵ Dështimi i akterëve të drejtësisë t'i përgjigjen në mënyrë adekuate mashtrimeve të raportuara në zgjedhje pas zgjedhjeve të mëparshme duket se ka rezultuar në shtim gradual dhe të përsëritur të rasteve të manipulimit që pohohet të jenë kryer gjatë zgjedhjeve të vitit 2010.⁶ Bashkësia ndërkombëtare e ka theksuar nevojën që institucionet e Kosovës duhet të merren me vendosmëri me rastet e mashtrimit në zgjedhje⁷ dhe organet më të larta të drejtësisë së Kosovës kanë deklaruar publikisht se krimet e lidhura me zgjedhjet janë prioritet⁸. Duke e respektuar këtë thirrje për veprim, prokurorët kudo në Kosovë kanë ngritur aktakuza kundër 1,343 personave dhe vlerësuan se edhe 931 persona tjerë do të ndiqeshin.⁹ Nga gjysma e vitit 2012, monitorimi nga OSBE-ja tregon

⁵ Pas një mocioni të paraqitur nga 32 deputetë të Parlamentit të Kosovës në Gjykatën Kushtetuese, me pohimin për shkelje të Kushtetutës nga, presidenti i atëhershëm i Kosovës, në shtator 2010 Gjykata Kushtetuese nxori aktvendim ku kishte gjetur se presidenti kishte shkelur Kushtetutën. Pas dorëheqjes së presidentit, dy partitë politike kryesore nuk arritën pajtim për presidentin e ri. Më 15 tetor 2010 u publikua një vendim që shpallte mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 13 shkurt 2011. Më 18 tetor 2010, njëra parti politike u tërhoq nga koalicioni qeverisës dhe të gjithë ministrat dhe zëvendësministrat nga ajo parti lëshuan postet e tyre. Pas këtyre zhvillimeve, një mocion mosbesimi ndaj qeverisë u miratua nga Parlamenti i Kosovës, pasuar nga dekreti për shpërndarjen e Parlamentit. Në pajtim me afatet kohore të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje, data për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme u caktua të jetë 12 dhjetori 2010.

⁶ Si rezultat i parregullsive të rënda, zgjedhje të përsëritura u mbajtën më 9 dhe 23 janar 2011 në disa komuna nëpër Kosovë. ENEMO raportoi se “një numër i lartë i parregullsive gjatë Zgjedhjeve Parlamentare në Kosovë kishin dëmtuar rëndë besimin në procesin demokratik në Kosovë. Shkelje të rënda të procedurave dukej të ishin pranuar dhe nuk kishte përpjekje nga stafi i vendotimeve për t'i ndërprerë sjelljet e parregullta në votim. Incidente të ngjashme dhe akte të pohuara të mashtrimeve të raportuara për zgjedhjet e 12 dhjetorit i japin një pamje të zbehtë procesit zgjedhor në Kosovë. Për më tepër, raste të frikësimit dhe presionit të ushtruar në vëzhguesit vendorë janë raportuar në ENEMO të cilat i shtohen mangësive tjera gjatë procesit.” Shih Raporti Përfundimtar i ENEMO, shënimi 3, *sipër*, në f. 3.

⁷ Për shembull, Raporti përfundimtar i ENEMO, shënimi 3, *sipër*, në f. 24; thotë “është shumë e rëndësishme që të hetohen në mënyrë të paanshme të gjitha shkeljet në zgjedhje, të ndiqen me kohë dhe të mbahen përgjegjës të gjithë kryerësit e veprave gjatë zgjedhjeve parlamentare të Kosovës 2010/11.” Shih gjithashtu, Raportin e Progresit të KE-së 2011, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf (më 25 shtator 2012); Kumtesë për shtyp e Parlamentit Evropian, “Nevojiten më shumë përpjekje për forcimin e demokracisë në Kosovë”, 10 janar 2011; Rezoluta e Parlamentit Evropian B7-0187/2012 për procesin e integritetit Evropian të Kosovës, 20 mars 2012, në para. 5, <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+MOTION+B7-2012-0187+0+DOC+PDF+V0//EN> (qasur më 25 shtator 2012).

⁸ Në shkurt 2011, Zyra e Prokurorisë së Kosovës lëshoi një njoftim publik me të cilin njoftonte që të gjitha shkeljet që lidhen me zgjedhjet do të trajtohen nga sistemi i drejtësisë si çështje me prioritet. Gjyqtarët do të kishin dy muaj kohë për t'i proceduar këto raste, përkundër faktit të mbingarkesës me raste. P.sh. shih “Njoftimin lidhur me hetimet e veprave penale lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë”, lëshuar nga Prokurori Publik i Kosovës më 1 shkurt 2011; Petrit Collaku, “Gjyqtari i Kosovës zotohet për ndërprerjen e mosndëshkimit në mashtrimet e votimeve”, *Balkan Insight*, 27 dhjetor 2010, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-election-manipulators-to-be-trialed> (qasur më 25 shtator 2012.)

⁹ Shih Raportin e Punës Vjetore të Zyrës së Prokurorit të Kosovës (janar-dhjetor 2011) lidhur me rastet e abuzimeve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010 në Republikën e Kosovës, 2 shkurt 2012, <http://psh-ks.net/?page=2.8.189> (qasur më 25 shtator 2012). Sipas raportit, zyrat komunale

që gjykatat tashmë kishin konfirmuar së paku 58 nga këto aktakuza dhe se ishin dhjetë gjykime kishin përfunduar. Gjetjet nga rinumërimi i KQZ-së, që zbuloi manipulim të gjerë të fletëvotimeve, shërben si bazë për shumicën e këtyre procedurave.

1.2 Raportimi i mëhershëm i OSBE-së për shkeljet e ndërlidhura me zgjedhjet

OSBE-ja ka raportuar rregullisht për rastet e mashtrimit në zgjedhje në sistemin e drejtësisë në Kosovë.¹⁰ Në raportet e mëhershme ka theksuar se pohimet për mashtrime në zgjedhje dhe krime të tjera që lidhen me zgjedhjet të kryera gjatë zgjedhjeve në Kosovë nuk i janë nënshtruar hetimeve apo ndjekjes efektive të kryerësve të pohuar, gjë që ka rezultuar me mosndëshkim për këto vepra. Raportet e mëhershme kanë ngritur shqetësime lidhur me dështimin e prokurorisë për hetimin dhe ndjekjen e shpejtë dhe të fuqishme të aktiviteteve mashtruese të kryera gjatë zgjedhjeve të vitit 2007 dhe 2009. Këto raporte gjithashtu nënvizuan mangësitë në bashkëpunim ndërmjet organeve të ndryshme zgjedhore, policisë dhe prokurorisë që kontribuuan në situatën ku dihet që vetëm disa raste penale ishin iniciuar nga prokuroria, e pak prej tyre arritën në gjykata.

1.3 Qëllimi, fushëveprimi dhe metodologjia e raportit

Qëllimi i këtij raporti është të vazhdojë punën e raporteve të mëhershme të OSBE-së mbi mashtrimet në zgjedhje në sistemin e drejtësisë, në mënyrë specifike raportit të muajit maj 2009, si dhe t'i vlerësojë zhvillimet në trajtimin e këtyre rasteve nga institucionet prokuroriale dhe gjyqësore në Kosovë.

Në raportin e vitit 2009, OSBE-ja raportoi se që nga data e publikimit nuk ishte mbajtur asnjë seancë gjyqësore në asnjë prej rasteve të pohuara të mashtrimit në votime, përkundër faktit që kishin kaluar një vit e gjysmë që nga koha kur kishin ndodhur shkeljet e pohuara në votime.¹¹ OSBE-ja raportoi se që nga viti 2009, zyrat komunale të prokurorisë kanë shqyrtuar 36 raste ku përfshihen së paku 57 persona, të cilët pohohet të kenë manipuluar në mënyrë aktive procesin zgjedhor, ose se paku në heshtje kanë pranuar keqpërdorimet.

Megjithatë, sa i përket zgjedhjeve të vitit 2010, është identifikuar qartë një rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve. Prokurorët nëpër Kosovë kanë ngritur akuzë për mashtrim në zgjedhje dhe vepra penale të tjera të lidhura me zgjedhjet në të paktën 198 raste, ndërkaq 133 raste të tjera janë në procedurë.¹²

OSBE-ja i ka dhënë përparësi monitorimit të rasteve të zgjedhjeve të 2010-ës. Metodologjia e përdorur për mbledhjen e informatave përkatëse është përbërë nga

të prokurorisë në Prishtinë/Priština dhe Prizren kanë një numër të konsiderueshëm të rasteve “në proces”. Këtu përfshihen 84 raste në Prishtinë/Priština dhe 49 raste në Prizren.

¹⁰ Shih Raporti i OSBE, *Spektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor*, – Raport mujor tetor/nëntor 2008, <http://www.osce.org/kosovo/38443> (qasur më 25 shtator 2012) dhe Raporti i OSBE-së, *Spektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor*, Raport mujor – maj 2009, <http://www.osce.org/kosovo/38404> (qasur më 25 shtator 2012).

¹¹ OSBE, Raport mujor – maj 2009, Ibid, në f. 4.

¹² Raporti vjetor i punës i Prokurorit të Shtetit, shënimi i 9-të i mesipërm. Të dhënat e përfshira në raport janë përditësuar nga monitoruesit e OSBE-së, përmes informatave të ofruara nga prokuroritë gjegjëse. Siç është raportuar, të dhënat personale për të dyshuarit mungojnë në rastin e lëndëve në procedurë. Prokuroritë kompetente kanë kërkuar që Policia e Kosovës t'i grumbullojë të dhënat e nevojshme. Sipas raportit të Prokurorit të Shtetit, pritet që të ngrihen aktakuza të drejtpërdrejta në të gjitha këto raste.

monitorimi i seancave gjyqësore, shqyrtimi i shkresave të lëndëve nëpër prokurori e gjykata, si dhe intervistat me prokurorë e gjyqtarë që merren me raste të tilla. Rastet janë përzgjedhur sipas radhës kronologjike të pranimit të tyre nga prokuroritë dhe gjykatat në të gjitha rajonet e Kosovës. Shkalla e manipulimit të votave nëpër komuna të ndryshme nuk është përdorur për t'i përcaktuar kriteret për monitorim. Gjithashtu, OSBE-ja ka shqyrtuar kornizën ligjore të zbatueshme, publikimet siç janë raportet nga organet e monitorimit të zgjedhjeve dhe akterët e tjerë gjegjësisht, të dhënat statistikore nga Prokuroria e Kosovës, kumtimet për media dhe artikujt e mediave të shkruara.

Ndërmjet marsit 2011 dhe qershorit 2012, ekspertët e gjykatave nga OSBE-ja kanë monitoruar 83 raste të veprave të lidhura me zgjedhjet në të gjitha rajonet e Kosovës. OSBE-ja ka monitoruar 7 raste në rajonin e Prizrenit, 12 raste në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, 12 raste në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, 42 raste në rajonin e Pejës/Peć dhe 11 raste në Prishtinë/Priština. Monitoruesit e OSBE-së kanë shqyrtuar aktakuzat e dokumentet tjera përkatëse ligjore dhe, për rastet që kishin arritur në këto faza, kanë marrë pjesë në seanca për konfirmim të aktakuzës dhe shqyrtime kryesore, si dhe kanë shqyrtuar vendimet për konfirmime të aktakuzave dhe aktgjyqimeve që ishin lëshuar.

Siç është nënvizuar më sipër¹³, ky raport përqendrohet në rastet e mashtrimit në zgjedhje që rrjedhin nga procesi i rinumërimit të votave, i urdhëruar nga KQZ. Monitorimi i OSBE-së ka shpalosur se këto përbëjnë pjesën më të madhe të të gjitha procedurave gjyqësore të nisura si përgjigje ndaj pohimeve për mashtrim të kryer gjatë zgjedhjeve të vitit 2010. Për shkak të numrit total të madh të këtyre rasteve dhe të procedimit të shpejtë të tyre nëpër faza të ndryshme procedurale nga akterët e drejtësisë në Kosovë, është e vështirë të përcaktohet numri i saktë i këtyre rasteve. Megjithatë, rastet e monitoruara nga monitoruesit e sistemit ligjor nga OSBE - të cilat krijojnë bazën për këtë raport, analizën, gjetjet dhe përfundimet e tij – përfaqësojnë mostrën e të gjitha rasteve të ngjashme të mashtrimit në zgjedhje, që ilustron modelet në shkallë më të gjerë nëpër Kosovë.

Ky raport është i ndarë në gjashtë pjesë. Pjesa e 2-të paraqet një vështrim të kornizës ligjore që rregullon ndjekjen e veprave të lidhura me zgjedhjet në Kosovë. Më pas, Pjesa e 3-të nënvizon shkurtimisht bazën kryesore të provave për procedurat gjyqësore për mashtrim në zgjedhjet e vitit 2010, d.m.th. mekanizmin për ankesa të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe procesin e rinumërimit të votave nga KQZ. Pjesa e 4-të analizon mangësitë në trajtimin e rasteve të mashtrimit në zgjedhje të bazuara në procesin e rinumërimit, së pari duke u përqendruar në ndjekjen penale, e më pas duke ekzaminuar mangësitë gjatë fazës së konfirmimit të aktakuzës, gjegjësisht shqyrtimit kryesor. Raporti përmbyllet me një numër rekomandimesh për prokurorët, gjyqtarët dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës.

2. KORNIZA NORMATIVE PËR NDJEKJEN PENALE TË VEPRAVE TË LIDHURA ME ZGJEDHJET

2.1. Korniza normative ndërkombëtare

¹³ Shih faqen 5 më sipër.

Zgjedhjet e lira e të drejta janë normë fundamentale e një shoqërie demokratike, siç është pasqyruar në shumë dokumente politike e ligjore.¹⁴ Vet Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në të drejtën parësore të saj mbi të drejtën për zgjedhje të lira, ka konfirmuar që zgjedhjet e lira mishërojnë “parimin karakteristik të një demokracie efektive dhe, për rrjedhojë, kanë rëndësi parësore në sistemin e Konventës”.¹⁵

E drejta për zgjedhje të lira përbëhet prej dy aspekteve: aspekti aktiv (d.m.th. e drejta për të votuar) dhe aspekti pasiv (d.m.th. e drejta për të vënë kandidaturën për zgjedhje). Që zgjedhjet të jenë vërtetë të lira e të drejta, të dy aspektet, si ai aktiv ashtu edhe ai pasiv, duhen ruajtur dhe mbrojtur me kujdes, përfshirë edhe përmes hetimit dhe ndjekjes efektive të rasteve të mashtrimit në zgjedhje.

Siç është njohur nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në Dokumentin e Kopenhagës:

“në mesin e atyre elementeve të drejtësisë që janë qenësore për shprehjen e plotë të dinjitetit të lindur dhe të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë qenieve njerëzore janë [...] *zgjedhjet e lira*, që do të mbahen në intervale të arsyeshme, me votim të fshehtë a procedurë të barasvlershme të votimit të lirë, në kushte që sigurojnë në praktikë shprehjen e lirë të mendimit të votuesve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre; [si dhe] *dëgjim të drejtë dhe publik* nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”¹⁶

Korniza normative ndërkombëtare përcakton obligime pozitive të autoriteteve për të hetuar dhe ndjekur veprat e lidhura me zgjedhjet. Komisioni Evropian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), në Kodin e tij të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore, me Udhëzimet e Raportin sqarues gjegjësisht, u vë detyrim të qartë autoriteteve për të “ndëshkuar çfarëdo mashtrimi në zgjedhje.”¹⁷

Megjithatë, çfarëdo procedurash penale që rrjedhin nga pohimet për mashtrim në zgjedhje duhet që të përmbushin gjithashtu standardet më të larta të një procesi gjyqësor të lirë dhe të drejtë, për t’i ndrequr parregullsitë në një mënyrë të ligjshme që i vërteton faktet dhe parandalon shkeljet e ardhshme.

¹⁴ Shih: *Dokumenti i Kopenhagës, OSBE, 1990*; Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (KDNI), *Komenti i përgjithshëm nr. 25: Neni 25 (Pjesëmarrja në çështje publike dhe e drejta për të votuar)*, 12 korrik 1996, UN Doc. CCPR/C/21/Rev.1/Add.7, që interpreton parimet për zgjedhje demokratike; shih gjithashtu *Kodin e praktikës së mirë në çështjet zgjedhore*, të hartuar nga Komisioni Evropian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) i Këshillit të Evropës.

¹⁵ Shih *Tanase dhe Chirtoaca kundër Moldavisë*, Vendimi i GJEDNJ i 18 nëntorit 2008, paragrafi 100. E drejta për zgjedhje të lira mishërohet në nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ). Shih gjithashtu nenin 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe nenin 21 të Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ).

¹⁶ Dokumenti i Kopenhagës, OSBE, 1990, Pjesa e 5-të (theks i shtuar në 5.1 dhe 5.16). Në dispozicion në: <http://www.osce.org/odihr/elections/14304> (e qasur me 25 shtator 2012).

¹⁷ Pjesa 3.2 (xv) e Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore, Udhëzimet dhe Raporti sqarues, i miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e 52-të të tij (Venedik, 18 – 19 tetor 2002), Strasburg, 23 maj 2003, Mendimi nr. 190/2002, CDL-AD (2002), rishikimi i 23-të. Në dispozicion në [http://www.venice.coe.int/docs/2002/CDL-AD\(2002\)023rev-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2002/CDL-AD(2002)023rev-e.pdf) (qasur më 25 shtator 2012).

E përcaktuar nga një numër instrumentesh bërthamë të të drejtave të njeriut, e drejta për proces të drejtë gjyqësor është pjesë përbërëse e konceptit të gjerë të epërsisë apo sundimit të ligjit, i cili është shtyllë e demokracisë moderne. Rëndësi kyçe për adresimin e mangësive të identifikuar në trajtimin e rasteve të mashtrimit në zgjedhje në Kosovë kanë e drejta për proces të drejtë gjyqësor para një gjykate kompetente¹⁸ dhe *prezumimi i pafajësisë*¹⁹ së të gjithë të pandehurve që përballen me akuza penale në këto raste.

2.2. Korniza normative në Kosovë

Mbrojtjet e mishëruara në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe protokollet e saj, si dhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare gjegjëse të tjera, janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në gjykatat e Kosovës. E drejta e garantuar ndërkombëtarisht për zgjedhje të lira dhe të drejta është pasqyruar gjithashtu edhe në kornizën normative të institucioneve të Kosovës.²⁰

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i njeh dhe mbron si të drejtën për të votuar ashtu edhe atë për të vënë kandidaturën në zgjedhje, d.m.th. aspektet aktive dhe pasive të së drejtës për zgjedhje të lira.²¹ Ai përcakton parimet themelore të kësaj të drejte²² dhe përvijon kriteret gjegjëse të pranueshmërisë.²³ Në veçanti, ligji rregullon çështje përkitazi me pranueshmërinë e votuesve²⁴, partitë dhe subjektet politike²⁵, certifikimin e kandidatëve²⁶, si dhe kodin gjegjës të mirësjelljes²⁷. Gjithashtu, ai vendosë rregullat për

¹⁸ *Shih*, PNDKP, neni 14(1): “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit. Për të qenë kompetent, anëtarët e gjyqësorit duhet të kenë kualifikime dhe përgatitje ligjore, si dhe duhet të sigurojë trajtim efektiv dhe të barabartë para ligjit, përfshirë, siç është demonstruar nga respektimi i së drejtës për një proces të rregullt dhe sundim të ligjit, edhe rregullat e administrimit të provave në procedurat penale.

¹⁹ *Shih*: KEDNJ, neni 6.2, “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”; dhe PNDKP, neni 14.2, “Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin”. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, në shtjellimin e tij të së drejtës për t’u prezumuar i pafajshëm sipas nenit 14(2) të PNDKP, ka vërejtur që: “Për arsye të prezumimit të pafajësisë, barra e provës për akuzën i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Nuk mund të prezumohet kurrfarë derisa akuza të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshmë. Veç kësaj, prezumimi i pafajësisë nënkupton të drejtën për t’u trajtuar në përputhje me këtë parim. Rrjedhimisht, është detyrë e të gjitha autoriteteve publike që të përmbahen nga paragjykim i rezultatit të procesit gjyqësor.” (Komenti i përgjithshëm nr. 13, par. 7.) Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka konstatuar që: “Paragrafi 2 (Neni 6.2) ngërthen parimin e prezumimit të pafajësisë. Ai kërkon, ndër të tjera, që gjatë kryerjes së detyrave të tyre, anëtarët e një gjykate nuk duhet të nisen nga paramendimi se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet; barra e provës bie mbi prokurorin dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Në vazhdim thuhet që është detyrë e prokurorit që të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen e tij, dhe të kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë.” (GJEDNJ, *Barbarà, Messeugè dhe Jebardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, A.146, f.33).

²⁰ *Shih për shembull*: Neni 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

²¹ Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, shënimi i 2-të i mësipërm, neni 2.

²² Ibid, neni 2.

²³ Ibid, Kapitulli II, III dhe IV.

²⁴ Ibid, Kapitulli II.

²⁵ Ibid, Kapitulli III.

²⁶ Ibid, Kapitulli IV.

²⁷ Ibid, Kapitulli V.

bërjen e fushatës zgjedhore²⁸, rolin e mediave²⁹ dhe vëzhguesve të zgjedhjeve³⁰. Ai përcakton organizimin dhe përgjegjësitë e organeve kryesore zgjedhore³¹, dhe procedurat e votimit³², numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve³³. Në fund, ligji përcakton sistemin zgjedhor për Kuvendin e Kosovës³⁴, financimin e zgjedhjeve³⁵ dhe krijon mekanizma e procedura për ankesa në lidhje me shkeljet në zgjedhje³⁶.

Ndjekja e veprave penale të lidhura me zgjedhjet rregullohet me Kodin penal të Kosovës (KPK)³⁷, gjegjësisht nenet 176 deri 181. Këto dispozita përfshijnë veprat penale parandalimi i ushtrimit të së drejtës së votimit³⁸, cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve³⁹, keqpërdorimi i së drejtës së votimit⁴⁰, cenimi i fshehtësisë së votimit⁴¹, mashtrimi në votime⁴² dhe asgjësimi i dokumenteve të votimit⁴³. Parimi i ligjshmërisë në të drejtën penale ndalon shqiptimin e sanksioneve penale për vepra apo mosveprime që në kohën e kryerjes apo moskryerjes së tyre nuk kanë qenë të përcaktuara si vepra penale.⁴⁴ Përgjegjësia penale për mosveprim ekziston vetëm në ato raste kur kjo është paraparë shprehimisht nga e drejta penale, që do të thotë se ligji duhet ta përcaktojë obligimin pozitiv për të vepruar, shkeljet e të cilit mund t'u nënshtrohen sanksioneve penale. Kjo nuk qëndron në rastin e veprës së mashtrimit në zgjedhje, si p.sh. rastet që rrjedhin nga procesi i rinumërimit. Neni 180 i KPK-së nuk përcakton në mënyrë specifike obligimin pozitiv të anëtarëve të këshillit të vendvotimit për ta verifikuar saktësinë e të dhënave mbi zgjedhjet që i kanë regjistruar anëtarët e tjerët të këshillit⁴⁵; pra, dështimi i këtyre personave për ta bërë këtë nuk përbën vepër penale dhe, për rrjedhojë, nuk mund t'u nënshtrohen sanksioneve penale.

Prandaj ligji parasheh, ndër funksione të tjera, ndjekjen penale të personave të cilët ndërmarrin veprime siç janë votimi i shumëfishtë; shkelja e fshehtësisë së votimit; kryerja

²⁸ Ibid, Kapitulli VI dhe VII.

²⁹ Ibid, Kapitulli VIII dhe XVII.

³⁰ Ibid, Kapitulli IX.

³¹ Ibid, Kapitulli X (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve), Kapitulli XI (Komisionet komunale të zgjedhjeve) dhe Kapitulli XII (Këshillat e vendvotimeve).

³² Ibid, Kapitulli XIII, XIV dhe XV.

³³ Ibid, Kapitulli XVI.

³⁴ Ibid, Kapitulli XVIII.

³⁵ Ibid, Kapitulli XIX.

³⁶ Ibid, Kapitulli XX.

³⁷ Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25, 6 korrik 2003, me plotësimet dhe ndryshimet pasuese. Më 6 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Ligjin nr. 03/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, qw e la kodin të njëjtë në thelb me ligjin e vitit 2003, me vetëm një shtesë të re mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe me ndryshimin e emërimit të kodit në Kodi penal i Kosovës, të cilit prej këtu e tutje i referohet si KPK.

³⁸ Ibid, neni 176.

³⁹ Ibid, neni 177.

⁴⁰ Ibid, neni 178.

⁴¹ Ibid, neni 179.

⁴² Ibid, neni 180.

⁴³ Ibid, neni 181.

⁴⁴ Shih Ibid, neni 1; neni 11.2 i DUDNJ; neni 15 i PNDCP; dhe neni 7 i KEDNJ, shënimi 155-të më sipër.

⁴⁵ Neni 180 i KPK, shënimi 377-të më sipër, parasheh përgjegjësi penale për personat që i falsifikojnë rezultatet e zgjedhjeve apo të votimeve në Kosovë duke shtuar, hequr apo shlyer votat a nënshkrimet, duke i numëruar në mënyrë jo të saktë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore apo në ndonjë mënyrë tjetër, ose i publikojnë rezultatet e zgjedhjes a të votimit që nuk i përgjigjen votimit të kryer.

e mashtrimit gjatë votimit, numërimit, regjistrimit apo publikimit të votave; apo asgjësimi në çfarëdo mënyre i dokumenteve të votimit. Ligji përcakton përgjegjësinë penale si të votuesve ashtu edhe të zyrtarëve zgjedhorë. Në varësi të seriozitetit të veprës, KPK përcakton dënime që fillojnë nga dënimi me gjobë e deri në pesë vjet burgim.

3. BAZA E DËSHMISË PËR PROCEDURAT E ZHVILLUARA NË RASTET E MASHTRIMIT GJATË ZGJEDHJEVE TË VITIT 2010

Procedurat penale që ndërlidhen me zgjedhjet e vitit 2010 kryesisht bazohen në ankesat e pranuar nga PZAP dhe me gjetjet nga procesi i KQZ-së për urdhërimin e rinumërimit.

3.1. Mekanizmi i PZAP-së për ankesa

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme e ka themeluar PZAP-në si organ të përhershëm të pavarur që është kompetent për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave⁴⁶ që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor⁴⁷. Çdo person që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor, mund të paraqesë ankesë pranë PZAP-së.⁴⁸ Përkitazi me parregullsitë dhe manipulimet e pretenduara gjatë zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të vitit 2010, PZAP ka pranuar gjithsej 454 ankesa.⁴⁹

3.2. Procesi i rinumërimit i urdhëruar nga KQZ-ja

Nën ombrellën e KQZ-së, si organ përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve në Kosovë,⁵⁰ është themeluar Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve (QNR).⁵¹ Ndër funksione tjera që ka QNR është përgjegjëse edhe për formularin e përputhjes së rezultateve, verifikimin dhe kontrollimin e listave të votuesve, intabulimin e tyre në tabela, rishikimin dhe auditimin e të dhënave zgjedhore dhe përpilimin e rezultateve

⁴⁶ Neni 122(1) i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, shënimi 2, *më sipër*, parasheh që ankesat zgjedhore janë një mjet juridik në dispozicion të çdo personi fizik apo juridik të drejtët ligjore të së cilin janë prekur nga vendimet e parapara me ligj të marra nga KQZ-ja.

⁴⁷ Shih nenin 115(1) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ibid. Neni 1 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme e ka riemëruar organin nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Ndër të tjera, nenet 6 deri 12 të të njëjtë ligj e kanë përcaktuar Gjykatën Supreme si shkallë e apelit për vendimet e PZAP-it në vend të Gjykatës Kushtetuese, neni 11 e ka rritur numrin e anëtarëve nga pesë në dhjetë përfshirë edhe kryesuesin, dhe nenet 12 dhe 15 i kanë precizuar afatet në disa procedura të caktuara të PZAP-it. Sipas nenit 115(2), Kryetari I Gjykatës Supreme e emëron kryesuesin e PZAP-it nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe anëtarët nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të qarkut.

⁴⁸ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ibid, neni 119(1). Ankesa dorëzohet brenda 24 orëve pas mbylljes së qendrave të votimit dhe PZAP-i vendos për ankesë brenda 72 orëve nga koha e pranimit të ankesës. Nenet 94(2) dhe 102(1) parashohin një mekanizëm shtesë të ankesave për votuesit, anëtarët e komisioneve të vendvotimit dhe vëzhguesit të cilët mund të shënojnë ankesat e tyre në librin përkatës të votimit; shih gjithashtu nenin 4(8) të Rregullit Zgjedhor të KQZ-së nr. 07/2009 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.

⁴⁹ Raporti final i ENEMO-s, shënimi 3, *më sipër*. PZAP ka pranuar 363 ankesa që kanë të bëjnë me votimet më 12 dhjetor 2010, dhe 84 ankesa shtesë që kanë të bëjnë me procesin e rivotimit më 9 dhe 23 janar 2011.

⁵⁰ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, shënimi 2, *më sipër*, Neni 1 dhe kapitulli X.

⁵¹ Rregulli Zgjedhor i KQZ-së nr. 06/2008.

përfundimtare të zgjedhjeve.⁵² Përmes këtij procesi, QNR ka vërejtur që gjatë numërimit dhe regjistrimit të votave në vitin 2010, shpërndarja e votave ndërmjet kandidatëve është manipuluar potencialisht në 890 nga 2,280⁵³ qendra të votimit. Në shumicën e rasteve, nëse jonë të gjitha rastet, kandidatët duket se kishin pranuar më tepër vota se sa subjekti politik që ata e përfaqësonin.⁵⁴

Sipas kuptimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kandidat është personi i cili garon për t'u bërë deputet i Kuvendit të Kosovës në kuadër të një partie politike.⁵⁵ Në ditën e zgjedhjeve, votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe a) e shënon atë me votën për një (1) subjekt politik, dhe b) mund që po ashtu të shënojë atë me vota për deri në pesë (5) kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar votuesi.⁵⁶ Në frymë të këtyre dispozitave, zgjedhja e kandidatëve është ngushtë e lidhur me votën për subjektin politik të cilin e përfaqëson kandidati, p.sh. kandidati nuk mund të pranojë votë ndryshe përveç nëse votuesi e ka ushtruar të drejtën e tij/saj për të votuar në favour të subjektit politik të cilit i përket kandidati. Prandaj sipas këtij sistemi, kandidati nuk mund të pranojë më shumë vota se sa partia politike të cilën ai ose ajo e përfaqëson.

Auditimi fillestar i të dhënave për zgjedhjet, i kryer nga QNR, ka zbuluar raste kur kandidatët kanë pranuar më shumë vota se sa partia politike që ata e përfaqësonin. QNR-ja e ka informuar KQZ-në për këto raste dhe ka rekomanduar që fletëvotimet nda disa vendvotime të caktuara të rinumërohen dhe hetohen në QNR. KQZ-ja e ka marrë këtë rekomandim dhe e ka urdhëruar QNR-në që të bëjë rinumërimin e votave në përrreth 40 për qind të vendvotimeve në tërë Kosovën. Ky proces i ka identifikuar 712 nga 890 vendvotime ku numri i votave për kandidat ishte i ndryshëm me numrin e votave për partinë politike. Rinumërimi kishte konfirmuar se formularët e rezultateve të kandidatëve nga këto vendvotime përmbanin gabime apo të dhëna të rrejshme.⁵⁷

⁵² Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, shënimi 22, *më sipër*, Neni 3. Shih gjithashtu rregullin zgjedhor të KQZ-së nr. 06/2008; QNR-ja e bënë auditimin e të dhënave duke i krahasuar formularët e përputhjes së rezultateve (FPR) me formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK), që përmbajnë vota për kandidatët individual. Raporti përfundimtar i ENEMO-s, shënimi 3, *më sipër*, në faqe 20, ka theksuar që çështjet më të shpeshta të zbuluara në QNR përkitazi me zgjedhjet e vitit 2010 kanë qenë lëshime në FPR dhe veçanërisht gabime apo të dhëna të rrejshme në FPR (përmbi 90 për qind).

⁵³ Raporti mbi Punën dhe Aktivitetet Vjetore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), janar-dhjetor 2010 (prill 2011), fq. 29.

⁵⁴ Raporti përfundimtar i ENEMO-s, shënimi 3, *më sipër*, në faqe 19-20. Për më shumë detaje rreth parregullsive të zgjedhjeve të parakohshme të 12 dhjetorit 2010 si dhe rivotimit të 9 janarit 2011, përfshirë këtu dështimet për kalimin e auditivit dhe dallimet ndërmjet votave për kandidatë individual dhe atyre për parti të tyre politike, shih: Raportin e KIPRED- *Krimet e Zgjedhjeve* tetor 2011. http://www.kipred.org/advCms/documents/62480_Denimi_i_manipuluesve_te_zgjedhjeve.pdf (e qasur më 25 shtator 2012).

⁵⁵ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, shënimi 22, *më sipër*; sipas nenit 3, kandidat është personi i cili garon për t'u bërë deputet i Kuvendit të Kosovës në kuadër të një partie politike apo iniciative qytetare.

⁵⁶ Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, Ibid, neni 110.4. Sipas paragrafit 5, nëse një fletëvotim shënohet për më shumë se pesë kandidatë, numërohet vetëm vota për partinë politike.

⁵⁷ Sipas KIPRED-it, në 80 për qind të këtyre rasteve (712 vendvotime) numri i votave për kandidatë kishte mospërputhje me votat e partisë politike. Në 20 përqindëshin tjetër të rasteve (178 vendvotime), ka pasur gabime që mund të kenë qenë të natyrës matematikore; shih raportin e KIPRED-it, *Krimet e Zgjedhjeve*, tetor 2011, http://www.kipred.org/advCms/documents/62480_Denimi_i_manipuluesve_te_zgjedhjeve.pdf (e qasur më 25 shtator 2012).

Si materiali që ka të bëjë me ankesat e PZAP-it ashtu edhe ai i procesit të rinumërimit të urdhëruar nga KQZ iu janë dërguar Prokurorisë Publike.⁵⁸ Ky raport përqendrohet në procedurat e mashtrimeve në zgjedhje vetëm në procesin e rinumërimit. Raporti analizon trajtimin e këtyre rasteve nga akterët gjyqësor, respektivisht prokuroria dhe gjykatat.

4. MANGËSITË NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË MASHTRIMEVE NË ZGJEDHJE NË BAZË TË PROCESIT TË RINUMËRIMIT TË URDHËRUAR NGA KQZ-JA NGA PROKURORIA DHE GJYKATAT

OSBE-ja e ka vërejtur një numër të mangësive në trajtimin e rasteve të mashtrimit në zgjedhje nga procesi i rinumërimit si nga prokuroria ashtu edhe nga gjykatat. Ato mangësi përfshijnë: dështimi i prokurorëve që me kujdes të duhur të hetojnë rastet e mashtrimeve të pretenduara të zgjedhjeve në secilin rast; ngritja e aktakuzave pa dëshmi të mjaftueshme; dështimi i gjykatave që të kontrollojnë sa duhet aktakuzat që nuk kanë dëshmi të mjaftueshme në fazën e konfirmimit; dhe dështimi i gjykatave për t'i shqyrtuar këto raste në mënyrë të thukët dhe të drejtë gjatë seancës kryesore në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe të drejtat e të pandehurve për proces të drejtë gjyqësor.

4.1. Ndjekja

4.1.1. Mangësitë e aktakuzave të drejtpërdrejta⁵⁹: dëshmitë e pamjaftueshme, arsyetimi i dobët dhe dështimi për individualizimin e veprimeve dhe përgjegjësisë penale të bashkëpandehurve.

OSBE-ja është e brengosur me mënyrën në të cilën prokurorët komunal i kanë trajtuar dyshimet për mashtrimet në zgjedhje që kanë dalë nga procesi i rinumërimit. Monitorimi i OSBE-së ka treguar që prokurorët i kanë udhëhequr këto raste në mënyrë sipërfaqësore, ku më tepër janë përqendruar në numrin e aktakuzave të ngritura se sa në cilësinë e tyre.

Që nga marsi i vitit 2011, prokuroritë komunale⁶⁰ në tërë Kosovën kanë ngritur një numër të madh të aktakuzave të drejtpërdrejta për mashtrimin zgjedhor në bazë të gjetjeve në procesin e rinumërimit. Monitoruesit e OSBE-së e kanë shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të këtyre aktakuzave: në Pejë/Peć, 28 aktakuza; në Gjakovë/Đakovica, 10 aktakuza; në Prishtinë/Priština, 1 aktakuzë; në Ferizaj/Uroševac, 2 aktakuza; në Prizren, 7 aktakuza; dhe në Gjiilan/Gnjilane, 5 aktakuza.

⁵⁸ Raporti Vjetor i Punës së Prokurorit Publik, shënimi 9, *më sipër*. Ndërmjet 30 dhjetorit 2010 dhe 9 janarit 2011, PZAP-i ka dorëzuar 191 raste në prokurorinë publike. Në mars të vitit 2011, prokuroria publike i ka pranuar lëndët nga QNR-ja me specifikime të manipulimeve përkitazi me votat e kandidatëve.

⁵⁹ Neni 304 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) parasheh që aktakuza mund të ngritet nga prokurori pas hetimeve (aktakuzë e rregullt) apo nëse prokurori publik konsideron që informatat që ai i ka lidhur me veprën penale dhe kryerësin ofrojnë bazë të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës [...] (aktakuzë e drejtpërdrejtë). Ngritja e aktakuzës së drejtpërdrejtë është paraparë në nenin 161 të KPK-së për veprat penale për të cilat dënimi kryesor është gjobë apo burgim deri tri vite.

⁶⁰ Sipas nenit 180 të KPK-së, vepra penale e mashtrimit në zgjedhje dënohet me burgim deri pesë vite, prandaj, në pajtim me nenin 21 të KPPK-së bie në kompetencë të gjykatave komunale.

Prokurorët kanë detyrë profesionale që të bëjnë hetime të përkushtuara, dhe vetëm nëse një gjë e tillë lejohet nga dëshmitë, të ndjekin të dyshuarit për vepra penale zgjedhore.⁶¹ Në kundërshtim me këtë prokuroritë kanë akuzuar një numër të madh të personave për mashtrime në zgjedhe zgjedhor pa kryer asnjë hetim. Si rezultat, aktakuzat e ngritura kanë shfaqur dëshmi të pakta dhe arsyeime të dobët, dhe kanë dështuar që plotësisht të individualizojnë veprimet dhe përgjegjësinë penale të bashkëpandehurve të ndryshëm.

Siç është theksuar më herët në këtë raport, procesi i rinumërimit ka zbuluar parregullsi në numërimin e votave në 890 vendvotime në tërë Kosovën.⁶² Prokurori Publik ia ka përcjellë këto gjetje së bashku me dëshmitë përkatëse, prokurorisë kompetente komunale për hetime të mëtutjeshme dhe ndjekje të mundshme të veprave që ndërlidhen me zgjedhjet.

OSBE-ja është informuar edhe për një udhëzim shtesë nga Prokuroria Publike që ka shërbyer si shtesë në gjetjet e rinumërimit.⁶³ Ky udhëzim i bën thirrje prokurorive publike komunale që të ngritin aktakuza të drejtpërdrejta p.sh. pa ndonjë hetim formal⁶⁴, në të gjitha rastet ku procesi i rinumërimit ka zbuluar parregullsi në vota përmbi një kufi të caktuar⁶⁵. Aktakuzat sipas këtij udhëzimi duhet t'i akuzojnë të akuzuarit me vepra penale të mashtrimit zgjedhor. Duhet të theksohet që mashtrimi zgjedhor është vepra më e rëndë penale në kategorinë e veprave penale që ndërlidhen me zgjedhjet; KPK parasheh dënim me burgim nga gjashtë deri pesë vite për këtë veprë të veçantë.⁶⁶

⁶¹ Prokurorët nuk duhet të iniciojnë apo vazhdojnë ndjekjen kur një hetim i pavarur tregon që akuza është e pabazuar: shih par 27 të Rekomandimit 2000(19) për rolin e Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale, të miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më 6 tetor 2000.

⁶² Shih shënimin 57 më sipër.

⁶³ OSBE-ja e ka pranuar një kopje të email-it të dërguar nga prokuroria publike te prokurorinë komunale në Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica dhe Gjiilan/Gnjilane, duke i urdhëruar që të ngriten aktakuza të drejtpërdrejta në të gjitha rastet ku procesi i rinumërimit ka nxjerrë në pah manipulim të votave përmbi një kufi të caktuar. Përveç kësaj, prokurorët duhet të kërkojnë dënime plotësuese sipas nenit 54(3) dhe (8) të KPK-së, p.sh. ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo shërbim publik dhe urdhri për të publikuar aktgjykimin. Rishikimi i dosjeve i bërë nga OSBE-ja ka zbuluar që disa prokurori komunale e kanë shpallur këtë udhëzim përmes emailit si kallëzim penal dhe si i tillë ka përbërë bazë për aktakuzat e radhës. Aktakuzat e ngritura nga prokuroria komunale e Gjiilanit i referohen në mënyrë të qartë udhëzimit të Prokurorisë Publike dhe e përmendin atë si dëshmi. Kryeprokurori komunal i Prizrenit e ka informuar OSBE-në që edhe zyra e tij e ka pranuar një udhëzim të ngjashëm.

⁶⁴ Nëse prokurori e konsideron që informatat që ai ose ajo i ka për veprën penale dhe për kryerësin ofrojnë bazë të mjaftueshme për aktakuzë, procedurat pranë gjykatës mund të zhvillohen vetëm në bazë të aktakuzës, p.sh. pa hetime. Neni 304(1) Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, më 6 korrik 2003, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Më 22 dhjetor 2008, Kosova e ka shpallur Ligjin nr. 03/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale nr. 2003/26, që e kishte lënë kodin në masë të madhe të njëjtë si ligji i vitit 2003, ndonëse është shtuar një pjesë për marrëveshjen për pranimin e fajësisë, një nen për ndalimin policor është ndryshuar, dhe emri i Kodit është ndryshuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, në tekstin e mëtutjeshëm KPPK..

⁶⁵ Shqyrtimi i OSBE-së i udhëzimeve të dërguara me email nga prokuroria publike për prokuroritë e ndryshme komunale, dhe intervistat me prokuror të ndryshëm, kanë zbuluar që komunave të ndryshme iu janë caktuar kufij të ndryshëm për sa i përketë asaj se kur aktakuzat e drejtpërdrejta duhet të ngriten, p.sh. Pejë/Peć 300 vota, Gjiilan/Gnjilane 400 vota, Viti/Vitina 500 vota.

⁶⁶ KPK, shënimi 37 më sipër, Neni 180: "Kushdo që i falsifikon rezultatet e zgjedhjeve apo të votimeve në Kosovë duke shtuar, hequr apo shlyer votat a nënshkrimet, duke i numëruar në mënyrë jo të saktë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore apo këtë e kryen në ndonjë mënyrë tjetër ose i publikon rezultatet e zgjedhjes a të votimit që nuk i përgjigjen votimit të kryer dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet."

Ligji i zbatueshëm procedural parasheh që prokurori do të ngrit aktakuzë kur ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar që i pandehuri ka kryer veprën e pohuar penale.⁶⁷ Aktakuza përmban shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës dhe provat që i vërtetojnë faktet kryesore.⁶⁸

Në rastet kur prokurori ngrit aktakuzë ndaj disa personave, atëherë aktakuza përmban hollësitë e veprimeve të secilit bashkëkryerës të pohuar sipas së cilave ai a ajo ka marrë pjesë në kryerjen e veprës ose i ka kontribuar në mënyrë thelbësore kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër.⁶⁹ Prandaj secili bashkëkryerës i pohuar duhet të mbahet penalisht përgjegjës (vetëm) për veprimet e tija a të saja përkritazi me veprën penale dhe (vetëm) brenda kufizimeve të qëllimit a neglizhencës së tij a saj.⁷⁰

Megjithatë në lidhje me lëndët e mashtrimit zgjedhor, prokurorët – në mënyrë kolektive dhe pa kryerjen e hetimeve – ngritën aktakuzë ndaj të gjithë personave të cilët ishin caktuar si anëtarë të këshillit⁷¹ të vendvotimit, ku si pasojë e rinumërimit u shënuan parregullsi përtej një pragu të caktuar. Në pajtim me udhëzimin e Prokurorit Publik, në shumë komuna faktori i vetëm vendimtar pas këtyre aktakuzave ishte numri i votave që u pohua se u manipuluan.⁷² Shembujt e rasteve në vijim demonstrojnë mangësitë e shënuara në këto aktakuza.

Më 23 qershor 2011, zyra e prokurorisë komunale në Prizren ngriti një aktakuzë ndaj shtatë të pandehurve për veprën penale të mashtrimit zgjedhor në bashkëkryerje. Sipas prokurorisë, më 12 dhjetor 2010 i pandehuri numër 1, në cilësinë e kryesuesit, dhe të pandehurit 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, në cilësinë e anëtarëve të këshillit të vendvotimit, me qëllim falsifikuan rezultatet e kandidatëve të zgjedhur duke shtuar dhe fshirë 63, përkatësisht 71 vota. Prandaj ata pohohet se manipuluan gjithsej 134 vota. Parregullsitë e veçanta u shënuan gjatë procesit të rinumërimit. Duke u bazuar në këtë, prokurori konstatoi që të pandehurit numëruan dhe regjistruan votat në mënyrë të pasaktë ndërsa materiali i KQZ-së u paraqit si provë. Pa asnjë provë apo arsyetim tjetër, në aktakuzë konstatohet që “provat e paraqitura janë bazë e mjaftueshme që të pandehurit 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, më 12 dhjetor 2010, kryen veprimet që theksohen në diapozitiv dhe kështu përmbushën të gjitha elementet thelbësore të veprës penale të mashtrimit zgjedhor në bashkëkryerje”. Asnjë provë nuk u paraqit në lidhje me atë se cilat veprime të veçanta a rrethana përbënë “bazë të mjaftueshme” për një konstatim të tillë, apo se cilat ishin elementet thelbësore të veprës penale në rastin e caktuar.

Më 19 janar 2012, zyra e prokurorisë komunale në Prishtinë/Priština ngriti aktakuzë ndaj shtatë të pandehurve për veprën penale të mashtrimit zgjedhor në bashkëkryerje. Ngjashëm me shembullin e rastit të mëparshëm, prokuroria pohoi

⁶⁷ KPPK, fusnota 644 *më sipër*; në përputhje me nenin 316(1)(4), gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës hedh aktakuzën kur nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

⁶⁸ KPPK, ibid, neni 305(1)(5).

⁶⁹ KPK, fusnota 37 *më sipër*, neni 23.

⁷⁰ KPPK, fusnota 644, neni 27(1).

⁷¹ KQZ-ja emëroi shtatë anëtarë të këshillit në secilin vendvotim për të organizuar dhe siguruar funksionimin e duhur dhe saktësinë e procesit zgjedhor. Anëtarët e këshillit ishin përgjegjës për tërë procesin e votimit, numërimit dhe regjistrimit të votave. Shih Rregullën zgjedhore nr. 09/2009 për votimin dhe numërimin brenda vendvotimeve në nivelin e komisionit komunal zgjedhor.

⁷² Shih fusnotat 633, 644 dhe 655 *më sipër*.

që më 12 dhjetor 2010 të pandehurit, në cilësinë e anëtarëve të këshillit të vendvotimit përgjegjës për procesin e votimit, me qëllim falsifikuan rezultatet e zgjedhjeve duke shtuar dhe fshirë votat për kandidatët e caktuar nga subjektet e ndryshme politike. Aktakuza i referohet provave të rinumërimit të KQZ-së që zbuluan se u manipuluan 1652 vota. Përveç materialit të KQZ-së, në aktakuzë nuk paraqitet asnjë provë apo arsyetim tjetër vërtetues. Në aktakuzë konstatohet që “sjellja e të pandehurve provon të gjitha elementet thelbësore të veprës penale me të cilën ata akuzohen”.

Për më tepër, shumë nga këto aktakuza kishin përmbajtje dhe formulim të ngjashëm të fjalive; dallonin vetëm të dhënat personale të të pandehurve, identifikimi i vendvotimit gjegjës dhe numri i votave të manipuluar.⁷³ Kjo paraqet edhe një shqetësim tjetër që formulari i njëjtë u përdor për të gjitha aktakuzat, duke i kushtuar pak apo aspak vëmendje rrethanave individuale të secilit rast.

Në tepër shumë raste, autoritetet e prokurorisë ngritën aktakuzat jo vetëm pa kryer ndonjë hetim, por edhe pa vendosur ndonjë kontakt paraprak me të dyshuarit.⁷⁴ Këta persona u njoftuan për aktakuzat e mashtrimit zgjedhor ndaj tyre vetëm pasi që aktakuza iu dorëzua atyre. Në të gjitha këto raste, seanca e konfirmimit të aktakuzës ishte rasti i parë për të pandehurit që të përgjigjen ndaj akuzave të ngritura ndaj tyre. OSBE-ja monitoroi seancat e konfirmimit të aktakuzës që zbuluan gabime serioze në aktakuzat e prokurorëve.

Më 21 shtator 2011 u mbajt një seancë e konfirmimit të aktakuzës në gjykatën komunale në Gjiilan/Gnjilane. Njëri nga të pandehurit kundërshtoi fuqishëm akuzat e ngritura ndaj tij nga zyra e prokurorisë komunale. Përkundër asaj se ishte caktuar nga KQZ-ja si anëtar i këshillit të vendvotimit, ai theksoi se në të vërtetë nuk kishte punuar në ditën e zgjedhjeve. Të pandehurit e tjerë vërtetuan se ky person nuk kishte qenë anëtar i këshillit të vendvotimit. Gjykata shqyrtoi dokumentacionin zgjedhor nga vendvotimi gjegjës që u paraqit si provë nga prokurori. Nënshkrimi i të pandehurit nuk ishte ndër nënshkrimet e anëtarëve të këshillit të vendvotimit. Vetëm atëherë gjykata e pushoi procedurën ndaj të pandehurit.

OSBE-ja monitoroi një numër të rasteve të ngjashme ku procedurat u pushuan në fazën e konfirmimit të aktakuzës për shkak se të pandehurit nuk kishin qenë të pranishëm në vendvotimin gjegjës, i cili ishte objekt i aktakuzës në ditën kritike; pra ata nuk kishin punuar si anëtarë të këshillit të vendvotimit apo kishin punuar në një vendvotim tjetër. Gabimet e tilla do të mund të ishin shmangur po që se prokurori gjegjës të kishte shqyrtuar në hollësi lëndën apo të kishte ndërmarrë hapa hetues shtesë, të tillë si marrja në pyetje e të pandehurve.

⁷³ OSBE-ja monitoroi ngritjen e aktakuzave të tilla nga zyrat e prokurorisë komunale në Prishtinë/Priština, Gjakovë/Djakovica, Gjiilan/Gnjilane, Prizren dhe Ferizaj/Uroševac.

⁷⁴ Monitorimi nga ana e OSBE-së zbuloi që të pandehurit në përgjithësi ishin kontaktuar vetëm në Prishtinë/Priština, ku zyra e prokurorisë komunale urdhëroi policinë që të merr deklaratën e të pandehurve para ngritjes së aktakuzës në bazë të rinumërimit. Të gjitha zyrat e tjera të prokurorisë komunale ngritën aktakuzat vetëm në bazë të materialit të KQZ-së, pa shqyrtuar apo edhe pa njoftuar të pandehurit në këtë aspekt. Në Prizren u monitorua një rast ku prokuroria kreu një hetim të mirëfilltë. Ky raport e paraqet këtë rast të veçantë si një shembull të praktikës së mirë; shih faqen 18 më poshtë.

Siç shihet nga shembujt e rasteve të paraqitura, shumë aktakuza që bazohen në gjetjet e rinumërimit u mbështeten kryesisht në materialet e siguruar nga KQZ-ja.⁷⁵ Këto aktakuza nuk kishin një arsyetim të duhur dhe në pjesën më të madhe dështuan tërësisht që të individualizojnë veprimet dhe rrjedhimisht përgjegjësinë penale të bashkëpandehurve të ndryshëm. Në shumicën dërmuese të këtyre rasteve, prokurorët nuk ndërmorën ndonjë hap hetues. Në disa raste, prokurorët as nuk konfirmuan atë nëse të pandehurit në të vërtetë kishin marrë përsipër detyrën e tyre të caktuar si anëtarë të këshillit të vendvotimit në ditën e zgjedhjeve, përmes shqyrtimit të kujdesshëm të provave në dispozicion apo kontaktit paraprak me të dyshuarit. Ngritja e drejtpërdrejtë e aktakuzave ndaj personave vetëm në bazë të detyrës së tyre të caktuar (si anëtarë të këshillit të vendvotimit) shkel obligimet dhe detyrat profesionale të prokurorëve përkitazi me kujdesin e duhur. Ajo mund të përbëjë shkelje të standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut; mangësitë serioze dhe flagrante në hetimet penale dhe ndjekja edhe e veprave penale për të cilat shqiptohet një dënim më i vogël përbën dështim të autoriteteve për të përmbushur obligimet e tyre pozitive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁷⁶

Sidoqoftë OSBE-ja ka edhe vërejtur zhvillime të reja pozitive. Rasti në vijim paraqet një shembull të praktikës së mirë për atë se si prokuroria duhet të trajtojë dyshimet për mashtrim zgjedhor që burojnë nga gjetjet e rinumërimit.

Më 5 mars 2012, zyra e prokurorisë komunale në Prizren ngriti aktakuzë ndaj dy të pandehurve për veprën penale të mashtrimit zgjedhor në bashkëkryerje. Pohimet e veçanta të mashtrimit buruan gjatë procesit të rinumërimit që zbuloi se votat për kandidatët ishin manipuluar në vendvotimet ku të pandehurit shërbenin si anëtarë të këshillit të vendvotimit. Rasti u trajtua nga një ekip i përzier i përbërë nga një prokuror vendas dhe një prokuror ndërkombëtar nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Në bazë të materialeve të KQZ-së, prokuroria nisi një hetim ndaj të gjithë shtatë anëtarëve të këshillit të vendvotimit. Hetimi përfshiu shqyrtimin e provave të KQZ-së por edhe dëgjimin e dëshmitarëve dhe të pandehurve. Si pasojë, prokuroria ngriti akuza ndaj dy personave nga këshilli i vendvotimit, domethënë ndaj kryesuesit dhe anëtarët të këshillit i cili shënoi të dhënat në formularët gjegjës. Hetimi ndaj pesë anëtarëve të tjerë të këshillit të vendvotimit u pushua për shkak të mungesës së provave. Aktakuza në këtë rast përmban një arsyetim të hollësishëm që analizon provat e mbledhura gjatë rrjedhës së hetimeve dhe kështu mundëson një shqyrtim të hollësishëm të veprimeve të zyrës së prokurorisë komunale.

Përkundër udhëzimit nga Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës⁷⁷, në shembullin e rastit të lartcekur prokuroria pranoi që provat nga procesi i rinumërimit ishin të pamjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar ndaj të gjithë anëtarëve të këshillit të vendvotimit. Duke marrë parasysh këtë, prokuroria nisi një hetim të mirëfilltë dhe të bazuar në provat e mbledhura gjatë tij, ngriti aktakuza ndaj dy anëtarëve të këshillit të vendvotimit dhe pushoi procedurat ndaj pesë të tjerëve. Ndonëse legjislacioni parasheh mundësinë e

⁷⁵ Materiali i KQZ-së që u përdor nga prokurorët për të ngritur aktakuzat për mashtrim zgjedhor ishte FPR, që përmbajnë votat për subjektet politike; FNR, që përmbajnë votat për kandidatët, të dyja siç regjistrohen nga anëtarët e këshillit të vendvotimit; raportin e auditimit të QNR-së që thekson mospërputhjet në mes të votave të numëruara dhe të regjistruara nga këshilli i vendvotimit dhe nga ekipi i auditimit, si dhe raportet gjegjëse të KQZ-së për zyrën e prokurorit publik.

⁷⁶ Shih *Blumberga kundër Letonisë*, Aktgjykim i GJEDNJ, i datës 14 tetor 2008, paragrafi 67.

⁷⁷ Shih fusnotat 63, 64 dhe 65 më sipër.

aktakuzës së drejtpërdrejtë pa ndonjë hetim paraprak⁷⁸, prokurorët duhet ta përdorin këtë mundësi vetëm atëherë kur kanë prova që janë të mjaftueshme për të arritur pragun e dyshimit të bazuar.

4.2. Gjykatat

4.2.1. Konfirmimi i aktakuzave: aktakuzat e konfirmuara në mungesë të dyshimit të bazuar ndaj bashkëpandehurve individual

OSBE-ja është e shqetësuar me rastet kur trajtimi i lëndëve të mashtrimit zgjedhor të vitit 2010 nga gjykatat në fazën e konfirmimit më shumë përforcon se sa që i korrigjon mangësitë e identifikuara të aktakuzave. Në tepër shumë raste, gjykatat konfirmuan aktakuza që nuk përmbushnin kushtet e nevojshme ligjore.

Monitoruesit e OSBE-së morën pjesë në seanca të konfirmimit të aktakuzës dhe/ose shqyrtuan vendimet gjegjëse të konfirmimit të aktakuzës në 15 lëndë: 10 lëndë në Pejë/Peć; 2 lëndë në Gjiilan/Gnjilane dhe 3 lëndë në Prizren. Monitoruesit e sistemit ligjor të OSBE-së janë të njoftuar për shumë më shumë raste ku ky lloj i aktakuzës u konfirmua pa asnjë ndryshim. Kjo do të thotë që edhe në këto lëndë gjykatat gjithashtu dështuan që të shqyrtojnë, në mënyrë të hollësishme, këto aktakuza sipas kushteve të nevojshme ligjore. Gjithsej monitoruesit e OSBE-së janë të informuar për 58 aktakuza që u konfirmuan dhe kaluan në fazën e gjykimit kryesor pa një shqyrtim të hollësishëm ligjor⁷⁹: 25 lëndë në Pejë/Peć; 25 lëndë në Gjiilan/Gnjilane; 6 lëndë në Prizren dhe 2 lëndë në Ferizaj/Uroševac.

Seanca e konfirmimit ka për qëllim vlerësimin e cilësisë së aktakuzës së prokurorit para kalimit të saj në gjykimin kryesor. Përveç kërkesave të tjera ligjore⁸⁰, gjykata konfirmon aktakuzën vetëm kur ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.⁸¹ Në rastet e aktakuzave ndaj disa personave, gjykata shqyrton dhe vendos për cilësinë e aktakuzës ndarazi në lidhje me secilin të bashkëpandehur. Përkundër kësaj, OSBE-ja ka monitoruar një numër të konsiderueshëm të seancave të konfirmimit ku gjykatësit dështuan në respektimin e këtyre normave ligjore, siç ilustron me shembujt në vijim:

Më 19 shtator 2011, u mbajt një seancë e konfirmimit të aktakuzës në gjykatën komunale në Pejë/Peć. Të pandehurit deklaruan se janë të pafajshëm dhe theksuan se prokurori nuk kishte paraqitur asnjë provë që do të dëshmonte përfshirjen e tyre në mashtrim zgjedhor. Gjykatësi i konfirmimit të aktakuzës hodhi poshtë këto kundërshtime pa asnjë arsytim të duhur. Në vend të kësaj, gjykatësi ia përmendi të pandehurve udhëzimin e zyrës së prokurorit publik të Kosovës që parasheh procedurat penale për të gjitha rastet ku mashtrimi i pohuar tejkalon 300 vota.

⁷⁸ KPPK, fusnota 64 *më sipër*, neni 304.1 Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori publik konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin bazë të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës, procedura para gjyqit mund të zhvillohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori publik.

⁷⁹ 58 aktakuzat e shqyrtuara përfshijnë 15 lëndët që u paraqituan për seanca të planifikuara të konfirmimit që u monitoruan nga OSBE-ja.

⁸⁰ KPPK, fusnota 64 *më sipër*, neni 305.

⁸¹ KPPK, ibid, neni 316(4) lexuar bashkë me nenin 316(1)(4).

Gjykatësi konfirmoi aktakuzën në tërësinë e saj dhe udhëzoi të pandehurit se të gjithat çështjet e tjera do të adresohen gjatë gjykimit kryesor.

Më 29 gusht 2011, Gjykata komunale në Deçan/Dečani ka konfirmuar aktpadinë në një rast të ngjashëm të mashtrimit në votime. Pa ndonjë arsyetim të mëtjemë gjykatësi ka konstatuar se ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin që të pandehurit kanë bërë mashtrim në votime në vendvotimin e saktësuar në aktakuzë. Lidhur me këtë, gjykatësi i është referuar dokumenteve të KQZ-së, të dorëzuara nga prokurori. Gjatë seancës kryesore të gjykimit më 17 nëntor 2011, gjykata ia ka paraqitur të pandehurve materialin e KQZ-së nga lënda e rastit për të vërtetuar nënshkrimet e tyre. Në këtë pikë është bërë e qartë që këto dokumente i përkisnin një vendvotimi tjetër dhe jo atij ku të pandehurit shërbyen si anëtarë të komisionit. Materiali i KQZ-së i dorëzuar nga prokuroria, në bazë të të cilit është konfirmuar aktakuza, paraqiti emrat dhe nënshkrimet e personave tjerë dhe jo të të pandehurve.

Monitorimi i OSBE-së nxori në pah që në një numër të konsiderueshëm të rasteve, gjykatat i kanë mbajtur seancat për konfirmim të aktakuzës vetëm si formalitet. Një numër i lartë i aktakuzave për mashtrim në zgjedhje janë konfirmuar në mungesë të dëshmive, që do ta mbështesnin dyshimin e bazuar kundër bashkë-të pandehurve individual. Shumica e aktvendimeve për konfirmimin e aktakuzave të të shqyrtuara nga OSBE-ja janë lëshuar të zbrazëta, u mungonte arsytimi adekuat dhe/ose i mjaftueshëm.⁸²

Kur gjyqtarët i konfirmojnë aktakuzat në mungesë të kushtit për dyshimin e bazuar, ata veprojnë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm. Kur ata i kalojnë këto raste në gjykimin kryesor, gjyqtarët gjithashtu nuk e shfrytëzojnë funksionin e para-përzgjedhjes të caktuar në fazën e konfirmimit, përmes së cilës e ngritin edhe më shumë numrin tanimë të madh të lëndëve në pritje për tu gjykuar dhe e rëndojnë gjendjen e rasteve të pazgjedhura.

4.2.2. Gjykimi kryesor: dështimi për të ekzaminuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë rastet kundrejt të bashkë-të pandehurve individual

OSBE-ja brengoset për instancat ku gjyqtarët kanë dështuar të realizojnë nivelin e kërkuar të kujdesit të duhur në gjykimin e rasteve të mashtrimit në zgjedhje, që kanë dal si rezultat i procesit të rinumërimit. Dështimi për të administruar provat e mjaftueshme dhe relevante, i sforcuar më tutje përmes mungesës së arsytimit adekuat në aktakuzat e lëshuara, nxiti dyshime nëse gjykatat kanë ekzaminuar tërësisht të gjitha faktet relevante të këtyre rasteve, kryesisht të lidhura me veprimet individuale dhe përgjegjësinë e bashkë-të pandehurve.

Deri në fund të qershorit 2012, seancat e gjykimeve kryesore kishin filluar tanimë në më së paku 21 raste⁸³, dhe janë përfunduar jo më pak se dhjetë raste në shkallën e parë⁸⁴.

⁸² KPPK, Ibid, neni 317(1) parasheh që të gjitha vendimet për konfirmim do të mbështeten me arsytimin adekuat por në atë mënyrë që të mos paragjykohet gjykimi i çështjeve që do të merren parasysh në gjykimin kryesor. Kjo është në mënyrë të qartë e lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë sipas nenit 6(1) të KEDNj-së, që përfshin të drejtën për vendim të arësytuar mirë. Shih raportin e OSBE-së *Shqetësimet lidhur me konfirmim të aktakuzës* (tetor 2010), http://www.osce.org/kosovo/73712_1 (i qasur më 25 shtator 2012).

⁸³ Në Pejë/Peć, tetë raste; në Gjakovë/Đakovica, dy raste; në Gjiilan/Gjnilane, një rast; në Prizren, gjashtë raste; dy në Ferizaj/Uroševac dhe një rast në Prishtinë/Priština.

Gjatë seancës kryesore të gjykimit, gjykata ka për detyrë të sigurojë që rasti të verifikohet tërësisht dhe në mënyrë të drejtë⁸⁵.

Gjykata duhet t'i mbledhë me saktësi dhe në mënyrë të plotë faktet e rastit, të cilat janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm.⁸⁶ Vëmendje e barabartë duhet t'i kushtohet si fakteve fajësuese ashtu edhe atyre shfajësuese dhe provës.⁸⁷

Siç është theksuar më parë në këtë raport⁸⁸, në rastet e bashkëpunimit secili bashkë i pandehur përgjigjet penalisht jo vetëm për veprimet e tij/saj lidhur me veprën dhe vetëm në kuadër të kufijve të qëllimit ose neglizhencës së tij/saj. Sipas këtij parimi, gjykata duhet t'i vlerësojë ndaras veprimet dhe përgjegjësinë penale të secilit bashkë-të pandehur.

Prezumimi i pafajësisë paraqet pjesën përbërëse të gjykimit të drejtë.⁸⁹ Ky parim e vendos barrën e provës mbi prokurorin dhe përfundimisht i garanton të akuzuarit përfitim nga dyshimi. Kjo do të thotë që prokurori ka barrën provave për të gjitha elementet e veprës kundrejt të gjithë të pandehurve dhe gjykata është e obliguar të interpretojë dyshimet faktike ose ligjore në favor të këtyre të pandehurve. Gjykata do ta dënojë të pandehurin vetëm kur prova e administruar dëshmon fajësinë e tij/saj përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.⁹⁰

OSBE-ja ka monitoruar 19 gjykime fillestare të mbajtura në lidhje me rastet e mashtrimit në votime që kanë rezultuar nga procesi i rinumërimit. Tetë prej këtyre rasteve janë përfunduar nga gjykatat e shkallës së parë. Monitorimi fillestar u bë në instancat ku gjyqtarët i gjykuan këto raste pa administruar prova të mjaftueshme ose prova gjegjëse për të vlerësuar dhe vendosur veprimet individuale dhe përgjegjësinë e bashkë-të pandehurve. Gjashtë prej tetë rasteve të përfunduara kanë rezultuar me dënime kolektive kundër të gjithë anëtarëve të komisionit të vendvotimit në gjykim, që ngrit shqetësime shtesë nëse dyshimet e dukshme në lidhje me meritat e këtyre rasteve me të vërtetë janë interpretuar në favor të të pandehurve siç parashihet me ligj. Shembujt në vijim i ilustrjnë disa prej këtyre mangësive:

Më 1 mars 2012, gjykata komunale në Gjiilan/Gnjilane ka dënuar katër të pandehur⁹¹ për kryerjen e veprës penale në bashkëveprim për mashtrim në votime

⁸⁴ Në Pejë/Peć, tre raste; në Gjiilan/Gnjilane, një rast; në Prizren, pesë raste; dhe në Ferizaj/Uroševac, një rast. Deri më tani, nuk është përfunduar asnjë rast në Prishtinë/Priština.

⁸⁵ KPPK, shënimi 64, më sipër, neni 333(2). Sipas nenit 360(5), përveç dëshmisë së propozuar nga palët, kolegji gjyqësorë do ta ketë kompetencën të mbledh prova që i konsideron të domosdoshme për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të rastit.

⁸⁶ KPK, shënimi 37, më sipër, neni 7(1).

⁸⁷ KPK, ibid, neni 7(2).

⁸⁸ Shih shënimin 70, më sipër.

⁸⁹ Neni 6(2) KEDNj; KPK, shënimi 37, më sipër, neni 3.

⁹⁰ Prezumimi i pafajësisë është thelbësorë në sistemin e drejtësisë penale. Dënimi penal mund të shkaktojë mundime të ndryshme për të pandehurin, duke përfshirë këtu burgosjen publike, gjobot dhe nënçmimin publik. Është në interesin publik që njerëzit e pafajshëm të mos dënohen, d.m.th., të mbrojnë individin e caktuar në gjykim por gjithashtu të ruajë mirëbesimin publik në integritetin dhe sigurinë e sistemit të drejtësisë. Kjo e shpjegon pse barra e provës mbetet tërësisht e prokurorit dhe standardin e sipër të të provuarit që kërkohet për dyshimin e arsyeshëm. Për diskutimin e mëtejshëm të këtyre parimeve, ju lutem shihni Simon Cooper, "Të drejtat e njeriut dhe barrat ligjore të dëshmisë" [2003] 3 Web JCLI; <http://webjcli.ncl.ac.uk/2003/issue3/cooper3.html> (qasur më 25 shtator 2012).

⁹¹ Prokuroria komunale në Gjiilan/Gnjilane ka ngritur padi kundër shtatë të pandehurve. Procedura është ndërprerë kundër tre të pandehurve në fazën e konfirmimit. Shih fq. 12, sipër.

dhe i ka dënuar me dy muaj burgim. Katër të pandehurit nuk e pranuan fajësinë. Si provë, gjykata i është referuar materialit të KQZ-së, që tregon se kandidatët e disa partive politike kanë marrë më shumë vota se vetë partitë. Gjukata e ka definuar këtë si “manipulim i dukshëm dhe i pa-tolerueshëm i votave”. Të pandehurit kanë deklaruar, që secili prej tyre kanë numëruar votat për partinë politike që ata e përfaqësonin dhe ishte kryesuesi ai që i plotësoi formularët. Katër të pandehurit e kanë konfirmuar që i kishin nënshkruar këta formularë pa ndonjë vërejtje, por disa prej tyre nuk kanë shikuar se çfarë po nënshkruajnë dhe që kryesuesi ka pasur mundësi t’i ketë mashtruar ata. Në bazë të provave të KQZ-së dhe deklaratave të të pandehurve, gjykata ka ardhur në përfundim që “të gjithë të pandehurit, si anëtarë të komisionit të vendvotimit ishin të përgjegjshëm për numërimin e votave dhe plotësimin e formularëve”. Prandaj, “me pjesëmarrjen e tyre aktive dhe pasive- të qetë, ata shtuan apo hoqën votat e qytetarëve dhe i regjistruan këto vota në formularët e rezultatit të kandidatëve”. Gjukata i ka shpall fajtorë të gjithë anëtarët e komisionit ngase “elementet e veprës penale që janë akuzuar ekzistojnë në aktet e tyre”. Megjithatë, gjykata nuk e ka saktësuar ose shpjeguar se cilat janë ato akte të caktuara.

Më 10 gusht 2011, gjykata komunale e Dragashit/Dragaš i ka dënuar shtatë të pandehur për kryerjen e veprës për mashtrim në votime në bashkëkryerje me dënimin me kusht prej gjashtë muajve burgim. Shtatë të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm. Si në shembullin e rastit të mëparshëm, koha e shqyrtimit të provave përbëhej prej leximit të materialit të KQZ-së dhe marrjes së deklaratave nga të pandehurit. Në aktgjykimin me shkrim, gjykata ka elaboruar në hollësi parregullsitë e zbuluara gjatë tërë procesit të rinumërimit. Aty pasqyroheshin mospërputhshmëritë në vota për secilin kandidat të ndikuar. Aktgjykimi më tutje jepte një pasqyrë mbi deklaratat e të pandehurve. Gjukata vërtetoi që secili i pandehur, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vendvotimit, ishte përgjegjës për numërimin e votave të partisë politike të tij/saj ndërsa kryesuesi— që ishte njëri prej të pandehurve — ishte ai kishte plotësuar formularët. Të gjithë të pandehurit e konfirmuan që i kishin nënshkruar formularët, ndonëse ata e pranuan që nuk e kishin kontrolluar korrektësinë e të dhënave të futura. Pa ndonjë arsytim të mëtutjeshëm, gjykata erdhi në përfundim që “veprimet e të pandehurve paraqesin të gjitha elementet që përbëjnë veprën penale të mashtrimit në votime”. Gjithashtu, në këtë rast gjykata e ka saktësuar në hollësi më të madhe se cilat ishin veprimet individuale të të pandehurve.

Në shembujt e rasteve të paraqitura, gjykatat kanë gjykuar këto raste dhe kanë lëshuar aktgjykime dënimi bazuar vetëm në materialin e KQZ-së dhe deklaratat e të pandehurve. Gjukata i ka shpallur fajtorë të gjithë të pandehurit për mashtrim në votime në bashkëkryerje, por deri tani ata kanë dështuar në marrjen e duhur në pyetje dhe bashkërenditjen e veprimeve të tyre individuale dhe përgjegjësinë për aktin penal. OSBE-ja brengoset që në këtë mënyrë, gjykatat nuk i kanë kryer detyrat e tyre me kujdes sa i përket ekzaminimit të të gjitha fakteve gjegjëse të rastit. Duke i pasur parasysh këto mangësi në përcaktimin e gjendjes faktike, dënimet e lëshuara mund ta komprometojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili kërkon që dyshimet të interpretohen në favor të të pandehurve. Përfundimisht, aktgjykimeve u mungonte arsytimi i duhur, gjë që më

tutje paraqiste pengesë për kontrollimin e duhur të veprimeve të gjykatës dhe në këtë mënyrë i minoi të drejtat e të pandehurve për gjykim të drejtë.⁹²

Veç kësaj, në një numër të konsiderueshëm të rasteve të monitoruara kohëve të fundit, gjykatat kanë zgjatur kohën e shqyrtimit të provave përveç leximit të materialit të KQZ-së dhe marrjes së nënshkrimeve të të pandehurve. Provat e reja të marra parasysht në dëgjimet e tilla përfshijnë marrjen në pyetje të dëshmitarëve⁹³ dhe rinumërimin e votave⁹⁴, por brengat vazhdojnë të qëndrojnë ende për sa i përket se në çmasë prova e re e mbështetë dyshimin e bazuar të përgjegjësisë individuale penale të personit të akuzuar.

Më 12 mars 2012, gjykata komunale në Pejë/Peć ka mbajtur seancën kryesore të gjykimit në vitin 2010 për rastin e mashtrimit në votime, që ka rezultuar nga procesi i rinumërimit. Gjykata ka marrë në pyetje dy dëshmitarë, që të dy anëtarë të Qendrës për Numërim dhe Rezultate. Dëshmitarët shpjeguan procesin e rinumërimit, duke përfshirë rolin individual dhe aktivitetet e tyre. Ata dhanë sqarime se si u zbuluan parregullsitë në vota dhe se si është marrë dhe si i ka vënë në pah të gjitha këto ekipi i auditimit i Qendrës për Numërim dhe Rezultate. Në seancën e njëjtë, kryetari i trupit gjykues ka njoftuar që gjykata do të kërkojë zyrtarisht nga KQZ-ja të bëjë përsëri rinumërimin e votave.

Në shembullin e rastit lartë, në seancën dëgjimore të anëtarëve të ekipit për auditim u pa si dëshmitarët ndriçuan rrethanat gjegjëse në lidhje me procesin e rinumërimit dhe parregullsitë në vota të zbuluara aty. Rinumërimi i ri i urdhëruar nga gjykata kishte për qëllim verifikimin e rezultateve të rinumërimit. Kjo zgjatje e kohës së shqyrtimit të provave padyshim paraqet hap pozitiv, por mbetet për t'u parë se si gjykatat do t'i shfrytëzojnë këto prova në caktimin e meritave të rastit, veçanërisht sa i përket veprimeve individuale dhe përgjegjësisë së bashkë të pandehurve. Shembulli i rastit në vijim demonstroi sfidat e mundshme:

Më 6 mars 2012, gjykata komunale në Deçan/Dečani i ka dënuar shtatë të pandehur për kryerjen e veprës për mashtrim në votime në bashkëkryerje dhe i ka dënuar ata me 90 ditë burgim. Përveç provave të KQZ-së dhe deklaratave të të pandehurve, gjykata ka urdhëruar rinumërimin e votave për vendvotimin e caktuar. Rinumërimi i ri i mbështeti rezultatet e rinumërimit të parë, që një numër i konsiderueshëm i votave është shtuar ose hequr. Në deklaratat e tyre, të gjithë të pandehurit deklaruan që ata nuk ishin përfshirë ose në dijeni për ndonjë manipulim. Disa të pandehur pohuan që nëse paraqiten gabime, atëherë ato kanë ndodhur jo-qëllimisht. Në vlerësimin e provave të saj, gjykata shpalli si të pakontestueshme që “të gjithë të pandehurit punuan në ditën kritike në vendvotimin përkatës, ku çdonjëri kishte detyrën e tyre dhe në fund të gjithë i nënshkruan formularët”. Gjykata nënvizoi provat e rinumërimit të ri, të cilat

⁹² Shih shënimin 82, *më sipër*. E drejta për një vendim të arsyetuar mirë është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së. KPPK, shënimi 61, *më sipër*, neni 403(1)(13), neni 401(1)(1) dhe (3). Mungesa ose arsytimi joadekuat mund të paraqesë shkelje thelbësore të procedurës penale. Sëbashku me përcaktimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, që të dyja mund të paraqesin bazë të vlefshme për ankesë me të cilën mund të kundërshtohet aktgjykimi.

⁹³ Në shumicën e rasteve, personat e përfshirë në procesin e rinumërimit kanë dëshmuar si dëshmitarë. OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar një rast në Prizren ku vëzhguesit e zgjedhjeve janë ftuar në gjyq si dëshmitarë.

⁹⁴ Vëzhguesit e OSBE-së kanë vërejtur praktikë të këtillë në Pejë/Peć, Deçan/Dečani, Gjakovë/Djakovica dhe Dragash/Dragaš.

konfirmuan mospërputhjet në vota. Gjykata erdhi në përfundim që këto prova dëshmuar që të pandehurit kanë shtuar dhe hequr votat e kandidatëve të ndryshëm, duke futur të dhëna jo të sakta në formularë dhe si rezultat, të pandehurit kanë manipuluar me 430 vota. Gjykata pohoi që “mbrojtja e të akuzuarve nuk qëndron sepse ata nuk e kanë arsyetuar veprimin e tyre me ndonjë dëshmi; mohimi si i vetëm nuk pranohet si dëshmi”. Gjykata i shpalli fajtorë të gjithë të pandehurit ngase “në veprat e tyre gjenden elementet e veprës penale për të cilat akuzohen ata”. Gjykata nuk i ka saktësuar në hollësi veprimet e të bashkëpandehurve të ndryshëm.

Në këtë shembull, gjykata me saktësi ka përcaktuar që votat janë manipuluar në vendvotimin e caktuar, siç është vërtetuar edhe me gjetjet e rinumërimit të parë dhe të dytë. Megjithatë, edhe në këtë rast, gjykata ka dështuar në vlerësimin e veprimeve individuale të bashkë-paditurve të ndryshëm në lidhje me këtë manipulim. Po në këtë rast, gjykata ka dënuar që të shtatë të bashkëpandehurit pa përcaktuar përfshirjen dhe përgjegjësinë e tyre individuale në mashtrimin zgjedhor.

Në gjitha rastet e paraqitura, gjykatat duket se kanë nxjerrë kolektivisht përgjegjësinë penale të të gjithë bashkë-pandehurve si anëtarë të komisionit të vendvotimit. Në këtë kuptim, gjykatat duket se nuk kanë dalluar nëse të paditurit kanë marrë pjesë në mënyrë aktive apo pasive në kryerjen e mashtrimit në votime, duke numëruar apo regjistruar në mënyrë të pasaktë votat e kandidatëve. Nëse dënohen anëtarët e komisionit për dështimin në verifikimin e korrektesisë së të dhënave të regjistruara, gjykatat i dënojnë ata në mënyrë implicite për mosveprim, pra dështim të anëtarëve të komisionit në kryerjen e kontroleve të arsyeshme të të dhënave të regjistruara në formularët zgjedhorë. Si në shembujt e paraqitur, është zakonisht kryesuesi ai që regjistron këto të dhëna.

Megjithatë, siç është theksuar më lartë, KPK nuk përcakton në mënyrë specifike ndonjë detyrë pozitive të anëtarëve të komisionit të vendvotimit në verifikimin e saktësisë së të dhënave zgjedhore të regjistruara nga anëtarët tjerë të komisionit, ashtu që dështimi i këtyre personave në kryerjen e këtij veprimi nuk është vepër penale, e rrjedhimisht as nuk mund të sanksionohet penalisht.⁹⁵ Për më tepër, siç është theksuar më herët në këtë raport, standardet ndërkombëtare vënë një prag veçanërisht të lartë të dëshmisë përtej dyshimit të arsyeshëm në të drejtën penale.⁹⁶ Në lidhje me këtë, gjykatat nuk duhet të peshojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve thjesht mbi faktin që ata kanë shkelur obligimet e tyre si anëtarë të komisionit të vendvotimit pasi që sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme do të mund të përbënte vetëm përgjegjësi civile.⁹⁷ Fakti që në shembujt e

⁹⁵ Shih tekstin më lart, në fusnotën 4545 *më sipër*.

⁹⁶ Shih fusnotën 900 *më sipër*.

⁹⁷ Përgjithësisht, anëtarët e komisionit të vendvotimit vërtetojnë saktësinë e procesit zgjedhor përmes nënshkrimit të formularëve përkatës. Secili gabim në formularët e nënshkruar duhet marrë si shkelje e obligimeve të anëtarëve të komisionit. Megjithatë, sipas nenit 102(2) të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, fusnota 2 *më sipër*, ligji parashikon një shkallë tjetër të përgjegjësisë për kryesuesin e tjetër për anëtarët e komisionit. Ai parashikon që *vetëm* kryesuesi duhet të jetë përgjegjës për përpilimin dhe saktësinë e rezultateve të numëruara nga vendvotimi të regjistruar në formularët e duhur, si dhe për dorëzimin e formularëve të plotësuar në vendin e caktuar. Neni 15(19) i Rregullit Zgjedhor 09/2009 të KQZ-së, fusnota 73 *më sipër*, gjithashtu përcakton që kryesuesi i vendvotimit është përgjegjës për përpilimin dhe saktësinë e rezultateve të numëruara, të regjistruar në formularët e caktuar për rezultate. Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme është ligj civil, i cili vetëm mund të përcaktojë përgjegjësinë civile. Në këtë kuptim, dallimet në përgjegjësinë e kryesuesit dhe anëtarëve të tjerë të komisionit të vendvotimit, të përcaktuara me këtë ligj, bëhen sekondare ndaj faktit që mungon baza ligjore për përgjegjësinë penale të veprës së mosveprimit në lidhje me kryerjen e mashtrimit në votime.

paraqitur si raste, gjykatat kanë dështuar në arsyetimin adekuat të vendimeve të nxjerra, vetëm e pengojnë edhe më shumë vëzhgimin e mirëfilltë të veprimeve gjyqësore.

OSBE-ja është edhe më tej e shqetësuar se duke refuzuar mbrojtjen e të akuzuarve sepse nuk kanë dorëzuar ndonjë dëshmi shfajësuese, gjykatat kanë komprometuar prezumimin e pafajësisë së të pandehurve. Në procedura penale, barra e dëshmisë mbetet plotësisht tek prokuroria.⁹⁸ Vijimisht, nuk kërkohet nga të pandehurit të vërtetojnë pafajësinë e tyre, e edhe përtej kësaj, çdo dyshim faktik apo juridik duhet interpretuar në favorin e tyre. Nga ky këndvështrim, gjykatat e Kosovës absolutisht nuk duhet që të interpretojnë apo mbajnë barra të tilla kundër të pandehurve, nëse ata dështojnë në paraqitjen e dëshmive për vërtetimin e pafajësisë së tyre.

Përkundër mangësive të përcaktuara më lart në gjykimin e rasteve të mashtrimit në votime në bazë të procesit të rinumërimit, OSBE-ja ka gjetur një shembull në të cilin gjykata ka vlerësuar veprimet dhe përgjegjësitë individuale të secilit të bashkë-pandehur. Qasja e analizës së gjykatës rast pas rasti është më afër me standardet normative (pavarësisht nga mos-përshtatshmëria evidente për të vendosur përgjegjësi penale sipas KPK-së pa dëshmi të qartë të qëllimit për kryerje të mashtrimit në votime):

Më 30 maj 2011, Gjykata Komunale në Ferizaj/Uroševac shpalli një të pandehur, një kryesues, fajtor për mashtrim në zgjedhje dhe e dënoi atë me një dënim me kusht prej gjashtë muajsh burgim, si dhe gjobë prej 800 eurosh. Gjykata liroi gjithë të pandehurit tjerë, të cilët kishin vepruar si anëtarë të komisionit në të njëjtin komision të vendvotimit, për mungesë provash.⁹⁹ Gjatë seancës kryesore, gjykata pranoi materialin e KQZ-së dhe deklaratat e të pandehurve si dëshmi. Gjithë të pandehurit deklaruan që kryesuesi ishte individ që kishte plotësuar formularët, ku ky dy anëtarët tjerë të komisionit diktonin informatat që shënoheshin në formularë. Gjithë anëtarët e komisionit konfirmonin që kishin nënshkruar formularët në fund. Në bazë të këtyre dëshmive, gjykata gjeti që “elementet e mashtrimit në votime ekzistojnë *vetëm* në sjelljen e të pandehurit, kryesuesit”. Gjykata gjeti që në pozitën e tij si kryesues, i pandehuri “kishte përgjegjësi të iniciojë dhe përfundojë procesin zgjedhor në mënyrë të drejtë, si dhe ai personalisht kishte plotësuar dhe nënshkruar gjithë formularët”. Për më tepër, gjykata i fali besimin dokumenteve të KQZ-së për shkak të “natyrës së tyre publike” si dhe për shkak se “asnjë nga të pandehurit nuk mohonte nënshkrimin e tyre”. Gjykata gjeti që sipas provave të pranura nga gjykata, “anëtarët e komisionit kishin diktuar rezultatet, si dhe ishte vetëm kryesuesi që i kishte shkruar ato”. Nga ky këndvështrim, gjykata e shpalli fajtor kryesuesin. Përkundër kësaj, gjykata liroi dy të pandehurit tjerë për shkak se “prokurori nuk kishte arritur të ndante përgjegjësinë e tyre”. Në këtë kuptim, gjykata i referohej dispozitave ligjore që theksojnë parimin sipas të cilit të pandehurit duhet të përfitojnë në rast dyshimi¹⁰⁰, obligimin e gjykatës që t’i kushtojë vëmendje të barabartë dëshmive shfajësuese dhe fajësuese¹⁰¹, si dhe mungesës së provave¹⁰².

⁹⁸ Shih fusnotën 900, *më sipër*.

⁹⁹ Në fjalën përmbyllëse, prokurori tërhoqi akuzat ndaj dy të pandehurve sepse kishte theksuar se nuk ishte provuar që secili prej tyre kishte kryer veprën e mashtrimit në votime.

¹⁰⁰ KPPK, fusnota 644, *më sipër*, neni 3(2).

¹⁰¹ KPPK, ibid, neni 7(1).

¹⁰² KPPK, ibid, neni 390(1)(3).

Në këtë rast, gjykata i ka kushtuar vëmendjen e duhur të pandehurve individualë dhe veprimeve të tyre në veprën e dyshuar. Vendimet e arsyetuara mirë jo vetëm që mundëson vëzhgimin e mirëfilltë të veprimeve të gjykatës në mënyrë transparente, duke arsyetuar edhe vendimin e gjykatësit, por edhe tregon gjykimin e thuktë dhe të drejtë të rastit, ku gjitha faktet e rastit janë shqyrtuar

5. PËRFUNDIMET

Hetimet efektive dhe gjykimet e veprave që kanë të bëjnë me zgjedhjet jo vetëm që sigurojnë përgjegjësinë e atyre që janë fajtorë për ato vepra, por edhe shërbejnë për të penguar shkeljet e ngjashme në të ardhmen. Dështimi në hetimin, dënimin dhe trajtimin e rasteve të mashtrimit mund të inkurajojë mos-ndëshkimin dhe përfundimisht të çojnë në përsëritje të veprave në zgjedhjet e ardhshme.

Gjetjet e procesit të rinumërimit të urdhëruar nga KQZ-ja kanë shërbyer si bazë për një numër të madh procedurash penale të iniciuara si reagim ndaj pohimeve për mashtrime në votimet e vitit 2010. Monitorimi i OSBE-së ka identifikuar aktakuza dhe procedim të një numri më të madh të lëndëve në krahasim me reagimin e sistemit gjyqësor të Kosovës ndaj rasteve të mashtrimeve të pretenduara gjatë zgjedhjeve të vitit 2007 dhe 2009, duke shënuar kështu një zhvillim të rëndësishëm pozitiv. Pavarësisht nga kjo, monitorimi i OSBE-së gjithashtu ka gjetur që aktorët e drejtësisë në Kosovë shpeshherë i kanë trajtuar këto raste në mënyrë sipërfaqësore, duke mbetur prapa në standardet e kërkuara të kujdesit të duhur. Raporti nënvizon faktin se këto procedura kaun shkelur standardet ndërkombëtare dhe kosovare, si dhe kanë komprometuar të drejtat e të pandehurve për gjykim të drejtë. Raporti paraqet shqetësime në lidhje me performancën e prokurorëve në fazën e procedurës paraprake si dhe trajtimi i këtyre rasteve nga gjykatat gjatë seancave të konfirmimit dhe atyre kryesore.

Në bazë të parregullsive të gjetura në procesin e rinumërimit, zyrat komunale të prokurorisë kanë akuzuar me qindra anëtarë të komisioneve të vendvotimeve për veprën e mashtrimit në zgjedhje. Prapëseprapë, OSBE-ja ka vërejtur që prokurorët i kanë kushtuar më shumë vëmendje numrit të madh të aktakuzave të ngritura sesa cilësisë së tyre. Në shumë raste, prokurorët kanë ngritur aktakuza pa hetime apo kontakte paraprake me të dyshuarit, thjesht në bazë të dëshmive nga procesi i rinumërimit. Si rezultat i kësaj, aktakuzave iu mungonte mbështetja për një dyshim të bazuar kundër të bashkë-pandehurve individualë, nuk përmbanin arsyetime fare apo kishin arsyetime të dobëta, si dhe dështonin në ndarjen e veprimeve dhe përgjegjësisë penale individuale të secilit të akuzuar. Prokurorët duken të kenë përdorur një shabllon identik për gjitha rastet, si dhe në disa raste, kanë akuzuar edhe persona që nuk kanë qenë të pranishëm në vendvotimet përkatëse në ditën kritike. Akuzimi i personave ekskluzivisht në bazë të pozitës së tyre të deleguar si anëtarë të komisionit shkel standardet e kujdesit të duhur dhe obligimeve profesionale të prokurorëve, si dhe mund të përbëjë edhe shkelje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁰³

Gjithashtu, pasi këto aktakuza arrinin fazën e konfirmimit, shumica e gjyqtarëve neglizhonin vlerësimin e mirëfilltë të cilësisë së tyre, për të cilën gjë ishin të obliguar me ligj. Në vend të kësaj, në shumë raste, gjyqtarët kanë trajtuar fazën e konfirmimit thjeshtë si formalitet. Ata kanë konfirmuar aktakuzat edhe në mungesë të një dyshimi të bazuar

¹⁰³ Shih shënimin 61, më sipër.

ndaj të bashkëpandehurve individuale, kanë nxjerrë vendime të njëtrajtshme pa arsyetime adekuate, si dhe gjerësisht kanë miratuar shumicën – nëse jo të gjitha – rastet në seancë kryesore. Kur gjyqtarët konfirmojnë aktakuza që nuk përmbushin kriteret e kërkuara ligjore, ata shkelin ligjin në zbatim si dhe dështojnë në shfrytëzimin e funksionit të zgjedhjes paraprake të fazës së konfirmimit, duke rritur edhe më shumë kështu numrin edhe ashtu të madh të gjykimeve në pritje, si dhe duke përkeqësuar më tutje ngarkesën me lëndë.

Deri nga shtatori 2012, vetëm një pjesë e vogël e gjitha rasteve të mashtrimit në votime, në bazë të procesit të rinumërimit, ka arritur në fazën e gjykimit kryesor. Megjithatë, monitorimi fillestar i gjykatave nga OSBE-ja ka gjetur raste ku gjykatat kanë pasur mungesë të standardit të kërkuar të kujdesit të duhur në gjykimin e këtyre rasteve. Veçanërisht shqetësues janë rastet në të cilat gjykatat kanë mbajtur dhe kanë përfunduar seancat kryesore, shpesh me vendime dënuese, vetëm në bazë të dëshmive të KQZ-së dhe deklaratat e të pandehurve. OSBE-ja është e brengosur që si rezultat i këtyre, gjykatat nuk kanë arritur të sigurojnë një shqyrtim të thukët dhe të drejtë të rastit siç përshkruhet sipas ligjit, sidomos në lidhje me veprimet dhe përgjegjësinë individuale të të bashkëpandehurve. Duke marrë parasysh këto mangësi, dënimet e shpallura gjithashtu kanë komprometuar parimin e prezumimit të pafajësisë, që është thelbi i të drejtës për gjykim të drejtë.

Përkundër mangësive të vërejtura, OSBE-ja ka monitoruar një numër rastesh me praktika të mira, ku akterët e drejtësisë në Kosovë kanë demonstruar performancë të kujdesshme, zbatim të përcaktimeve ligjore dhe respektim të të drejtave për gjykim të drejtë, qasje në drejtësi dhe parime të kujdesit të duhur.

6. REKOMANDIME

Për prokuroritë komunale:

- Të hetohen me vendosmëri të gjitha dyshimet për mashtrim në votime të cilat dalin nga gjetjet e procesit të rinumërimit;
- Të ngrihen aktakuza vetëm kur ka dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar që i pandehuri(t) ka kryer veprën penale;
- Të arsyetohen të gjitha aktakuzat në mënyrë të mirëfilltë. Në raste me më shumë të pandehur, të theksohen qartas veprimet e secilit të pandehur, përmes së cilave ai apo ajo ka marrë pjesë, apo në masë të konsiderueshme ka kontribuar në kryerjen e veprave penale.

Për gjyqtarët e gjykatave komunale:

- Të konfirmohen aktakuzat vetëm kur përmbushen të gjitha kriteret ligjore, duke përfshirë edhe praninë e një dyshimi të bazuar ndaj secilit të pandehur;
- Të arsyetohen mirë gjitha vendimet për konfirmim;
- Në seancën kryesore, të shqyrtohen thellësisht gjitha faktet përkatëse të rastit. Në rastet me më shumë se një të pandehur, të shqyrtohen veprimet dhe përgjegjësia individuale në lidhje me secilën veprë penale të akuzuar;

- Të vlerësohen me kujdes kërkesat e palëve për dëshmi dhe/ose *ex officio* të urdhërohen dëshmi të tilla të cilat janë të domosdoshme për gjykim të drejtë dhe të plotë të rastit;
- Të njihet parimi i prezumimit të pafajësisë, të cilat i lënë barrën e dëshmisë prokurorit, si dhe t'i garantohet të pandehurve përfitimi përfundimtar nga dyshimi;
- Të njihet parimi i ligjshmërisë kur vlerësohet përgjegjësia penale e të pandehurve për mosveprim në mashtrim në votime;
- Të mos nxirret përgjegjësia penale e të pandehurve nga roli dhe obligimet e tyre si anëtarë të komisionit të vendvotimit;
- Të arsyetohen mirë dhe mjaftueshëm gjitha aktvendimet dhe aktgjykimet, duke i kushtuar vëmendje secilit element të veprës dhe secilit kryes.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- Të sajohen trajtime për gjyqtarë dhe prokurorë penalë për rolin e seancave për konfirmimin e aktakuzave dhe standardet e aplikuara për dëshmi;
- Të merret parasysh trajnimi për gjyqtarë dhe prokurorë penalë për legjislacionin që rregullon veprat në lidhje me zgjedhjet.

SHTOJCA
Pasqyrë statistikore e veprave në lidhje me zgjedhjet e vitit 2010 e datës
2 shkurt 2012¹⁰⁴

Zyra komunale e prokurorisë	Rastet e pranuar¹⁰⁵	Aktakuzat¹⁰⁶	Propozim-akuza¹⁰⁷	Rastet e refuzuara/ mbyllura/ bartura për kompetenca	Rastet në proces¹⁰⁸	rastet e përfunduara në shkallë të parë
Prishtinë/Priština	160	21	19	36	84	12
Ferizaj/Uroševac	47	38	-	9	-	8
Gjilan/Gnjilane	58	31	2	27	-	2
Gjakovë/Đakovica	33	12	1	21	-	2
Pejë/Peć	47	30	-	11	-	3
Mitrovicë/Mitrovica	55	4	7	12	-	5
Prizren	95	30	3	15	49	3
GJITHSEJ	495	166	32	131	133	36

¹⁰⁴ Raporti Vjetor i Punës së Prokurorisë Publike (janar-dhjetor 2011), mbi rastet e keqpërdorimeve në zgjedhjet e hershme parlamentare të 12 dhjetorit 2012, http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_i_punes_vjetore_janar-dhjetor_2011_per_lendet_qe_kane_te_bejne_me_keqperdorimet_ne_zgjedhje_e_parakohshme_parlamentare_te_dates_12_dhjetor_2010_ne_Republiken_e_Kosoves.pdf. (e qasur me 25 shtator 2012).

¹⁰⁵ Këto raste përfshijnë ankesat në PZAP (rreth 191 raste, parashtruar mes 30 dhjetorit 2010 dhe 9 janarit 2011), fusnota 58, *më sipër*, si dhe gjetjet e rinumërimit nga KQZ-ja (rreth 304 raste).

¹⁰⁶ Monitorimi dhe intervistat e OSBE-së me prokurorët kompetentë kanë treguar që shumica dërmuese e aktakzave të ngritura në lidhje me zgjedhjet e vitit 2010 janë bazuar në procesin e rinumërimit. Një përjashtim është tek zyra komunale e prokurorisë në Mitrovicë/Mitrovica, që nuk ka ngritur aktakuza të tilla.

¹⁰⁷ KPPK, fusnota 64, *më sipër*, neni 461 ff. Procedurat e përsheptuara janë procedura të thjeshtuara, pa seancë konfirmimi, që lejohet për vepra penale të dënueshme me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

¹⁰⁸ Në këto raste, të dhënat personale të të dyshuarve janë raportuar të mungojnë. Zyrat kompetente të prokurorisë kanë kërkuar që Policia e Kosovës të mbledhë të dhënat e nevojshme. Sipas Raportit Vjetor të Punës së Prokurorisë Publike, fusnota 10, *supra*, aktakuzat direkte priten të ngrihen në të gjitha këto raste.